



MATURA SHTETËRORE NË SHQIPËRI, 2012



FONDACIONI
SHOQËRIA
E HAPUR
PËR SHQIPËRINË

FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË
MATURA SHTETËRORE NË SHQIPËRI, 2012

ADRESA

Rr. Qemal Stafa, Pallati 120/2, Tirana, Albania

Tel: +355 4 22 34 621/ 22 34 223/ 22 35 856

Fax: +355 4 22 35 855

E-mail: info@soros.al

Web-page: www.soros.al

DESIGN & LAYOUT

Henrik Lezi



MATURA SHTETËRORE NË SHQIPËRI, 2012

TIRANË, 2013

Kuadri rregullues i Maturës Shtetërore	10
Kampioni dhe metodologjia e studimit	11
Gjetjet kryesore	12

KAPITULLI 1

PARAPËRGATITJA E MATURËS SHTETËRORE 2012- SIBORA DHIMA	16
Informacioni mbi provimet e MSH-së	17
Këshillimi për karrierën	18
Alterteksti dhe Matura Shtetërore	19
Prioritarizimi i lëndëve	20
Këshillimet falas të ofruara në shkollat e mesme publike	20
Kurset private	23
Përmbajtja e testeve të MSH-së	24
Përzgjedhja dhe trajnimi i administratorëve të Provimeve të MSH-së	24

KAPITULLI 2

ADMINISTRIMI I PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2012 - AURON PASHA	28
Ambientet e provimit	29
Ora e fillimit të provimit	29
Identifikimi i Maturantëve	29
Shpërndarja e tezave	30
Përdorimi i celularëve	28
Persona të paautorizuar	32
Kopjimi gjatë zhvillimit të provimit	33
Koha në dispozicion për provimet	35
Vlerësimi për administratorët	35

KAPITULLI 3

VLERËSIMI DHE SHPALLJA E REZULTATEVE - ENDRIT SHABANI	36
Procesi i vlerësimit të provimeve	37
Ankimi ndaj rezultatit të vlerësimit	40
Vlerësim i përgjithshëm për MSH-në	42
Rekomandime	44

Matura Shtetërore dhe Arsimi i Lartë Publik	
Studimi Post – Matura dhe Arsimi i Lartë Publik	49
Hyrje	50
Metodologjia dhe marzhi i gabimit	50

KAPITULLI 1

PËRVOJA NË ARSIMIN E MESËM - SIBORA DHIMA	54
Cilësia e shkollimit	55
Orët e studimit	56
Lëndët e zhvilluara	57
Vlerësimi i mësuesve	58
Tekstet shkollore dhe mënyra e vlerësimit	59

KAPITULLI 2

VLERËSIME TË MATURËS SHTETËRORE- ENDRIT SHABANI	60
Nxënësit dhe përgatitja e tyre për maturën shtetërore	61
Orientimi për shkollën e lartë dhe këshillimi i karrierës	64
Provimet e Maturës	65

KAPITULLI 3

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË ZGJEDHJEN E DEGËS DHE VIJUESHMËRINË E PERFORMANCËS: SHKOLLË E MESME – MATURË SHTETËRORE - UNIVERSITET AURON PASHA	68
Mesatarja e notave	69
Motivimi	69
Performanca e studentëve sipas preferencës së degës/fakultetit.	71
Orët e studimit..	72
Krahasimi i cilësisë së shkollimit	73

KAPITULLI 4

PËRVOJA ME ARSIMIN E LARTË PUBLIK - DRITAN NELAJ	76
---	----

FJALË PËRSHËNDETËSE

Matura Shtetërore është një prej procesve më të rëndësishme në sektorin e arsimit shqiptar. Pësja e saj përcaktohet njëherazi në rëndësinë që ajo ka në përcaktimin e rrugëtimit të mëtejshëm arsimor të rinjve si dhe në ndikimin në cilësinë e arsimit të lartë.

Matura Shtetërore është një proces voluminoz dhe i ndërlikuar por në parim një përgjigje e pranueshme sa ka të bëjë me përmbushjen e parimit meritë – preferencë, ndërtimin e një standardi kombëtar të arsimit parauniversitar, krijimin e një treguesi të njësuar rreth cilësisë së institucioneve arsimore sikundër dhe një mekanizëm për të siguruar një shpërndarje eficiente të maturanëve në arsimin e lartë. Gjithësesi, Matura Shtetërore nuk mund të konsiderohet një ishull i vetmuar, larg ndikimit të pafundësive të institucioneve për të administruar mirë politikat kombëtare, e imunizuar nga prirjet e individëve për të përfituar në kurriz të rregullave dhe të drejtësisë sociale apo e paprekshme nga mendësia e përgjithshme e shmangies së sistemit për të ecur më shpejt në terma personal.

Vazhdimisht janë hasur raste në të cilat raportohen probleme të shumta lidhur me administrimin e Maturës Shtetërore në terren, të lidhura këto si me procesin e përgatitjes për provimet ashtu dhe me administrimin e tyre sikundër dhe me procesin e vlerësimit dhe shpalljes së rezultateve. Për të kuptuar më mirë problematikat që shoqërojnë Maturën Shtetërore sikundër dhe impaktin e saj në arsimin e lartë u realizua ky studim i cili përmes mbledhjes së të dhënave cilësore dhe sasore mbulon kënaqshëm një periudhë domethënëse të pikëtakimit midis sistemit të arsimit parauniversitar me atë të lartë. Studimi merr në vëmendje periudhën parapërgatitore për provimet e Maturës Shtetërore, zhvillimin e provimeve, vlerësimin dhe shpalljen e rezultateve sikundër dhe përvojën dhe performancën akademike të studentëve të arsimit të lartë të cilët kanë udhëtuar përmes Maturës Shtetërore.

Tematika e këtij studimi ka një rëndësi të veçantë pasi proceset në fokus kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e maturanëve sikundër dhe në prespektivën e shoqërisë shqiptare pasi arsimit i lartë përgatit burime njerëzore të kualifikuara me peshë të rëndësishme në përcaktimin e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik.

Studimi mund të shërbejë si burim i rëndësishëm të dhënash, arsyetimi dhe reflektimi lidhur me zbatimin e Maturës Shtetërore dhe rolin e saj faktik në zhvillimin e arsimit të lartë.

ANDI DOBRUSHI

Drejtor Ekzekutiv

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

1. KUADRI RREGULLUES I MATURËS SHTETËRORE

Matura Shtetërore është një sistem vlerësimi, i cili që prej vitit 2012 rregullohet me akte nënligjore të bazuara në ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, neni 51. Aktet nënligjore në fuqi, deri në daljen e akteve të tjera, janë Udhëzimet e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, si më poshtë:

- “Rregullore për Procesin e Maturës Shtetërore 2013 në Republikën e Shqipërisë” Datë 07.01.2013
- Udhëzim nr.35 “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore” datë 27.11.2012
- “Masat për transportimin e maturantëve/kandidatëve gjatë provimeve të MSH 2012”
- “Procedurat e njësimit të dëftesave/diplomave të shkollave të mesme të shtetasve shqiptarë dhe të huaj që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë shtetit” datë 19.01.2012
- “Masat për zhvillimin e provimeve të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore 2011” datë 26.07.2011

Që prej vitit 2006 e deri në vitin 2012, kur doli ligji i ri për arsimin parauniversitar, Matura Shtetërore është rregulluar me udhëzime të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës të bazuara në vendimet e Këshillit të Ministrave, VKM 78, datë 08.02.2006 dhe VKM 876, datë 03.11.2010.

2. KAMPIONI DHE METODOLOGJIA E STUDIMIT

Monitorimi i Maturës Shtetërore 2012 u përqendrua në shtatë qytete të rëndësishme për nga pikëpamja e përfaqësimit të diversitetit gjeografik dhe social të popullatës (Tiranë, Shkodër, Kukës, Elbasan, Fier, Vlorë dhe Korçë), ndërkohë që përmes metodave sasiore të kërkimit shkencor u grumbulluan të dhëna edhe në një shtrirje më të gjerë, duke përfshirë respondentë nga qytete të tjera të vendit.

Në kuadër të këtij monitorimi grupi i ekspertëve përzgjodhi metodologjinë dhe kampionin duke u bazuar në mënyrën e organizimit të Maturës Shtetërore, si dhe duke marrë në konsideratë aktorët e përfshirë në të gjitha fazat e këtij procesi. Ekspertët ndërtuan instrumentet për metodat cilësore dhe sasiore, të cilat shënjestruan ish - maturantët, mësuesit, administratorët dhe vlerësuesit e provimeve.

Anketa online u zhvillua gjatë muajve korrik-shtator 2012, në kohën kur maturantët i kishin zhvilluar të gjitha provimet dhe ishin njohur me rezultatet. Platforma u ndërtua në *limesurvey* dhe u promovua në rrjetin social Facebook, ku u programua që t'u shfaqej vetëm të rinjve me banim në Shqipëri, të grupmoshës 18-19 vjeç. Anketa online u vizitua nga 10 536 vizitorë të kësaj grupmoshe. Ajo është plotësuar nga 3467 maturantë, ndër të cilët vetëm 998 kanë plotësuar të gjithë pyetjet.

Pas filtrimit përmes pyetjeve filter-kampioni pëfundimtar ishte 779 maturantë me banim në këto qytete: Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë. Më pas rezultatet e dala, pasi janë ponderuar sipas të dhënave demografike, janë përpunuar në programin SPSS.

Për të kuptuar në thellësi problematikat e identifikuara përmes metodave sasiore, janë përdorur metodat cilësore të kërkimit shkencor. Kështu, gjatë muajit tetor 2012, në qytetet Tiranë, Shkodër, Kukës, Elbasan, Fier, Vlorë dhe Korçë u zhvilluan 7 fokus-grupe me maturantë dhe në secilin fokus-grup morën pjesë 7 – 10 pjesmarrës, sipas profileve të paracaktuara paraprakisht nga grupi i ekspertëve. Gjithashtu, në këto qytete u zhvilluan intervista të thelluara, gjysëm të strukturuar, me 14 mësues, të cilët jepnin mësim në klasat e dymbëdhjeta, 14 administratorë dhe vlerësues provimesh, si dhe me përfaqësues të Inspektoratit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar (IKAP), përgjegjës për monitorimin e Maturës Shtetërore. Për secilin fokus-grup dhe intervistë të thelluar, ekspertët e projektit përgatitën guidat dhe profilet, të cilat u ndërtuan në bazë të fazave të Maturës Shtetërore, profilet të subjekteve, si dhe problematikave të identifikuara para dhe gjatë studimit.

3. GJETJET KRYESORE

Parapërgatitja për Maturën Shtetërore

- Siç është vënë re edhe në vitet e mëparshme, ka pasur një përqëndrim të theksuar mbi rregullat dhe detyrat e maturantëve, ndërkohë që sqarohen jo sa duhet të drejtat e tyre. Një shembull është qasja e përgjithshme e maturantëve ndaj këshillimit falas të ofruar në shkollë, që shihet më shumë si shprehje e vullnetit të mirë të mësuesve sesa si e drejtë e nxënësve. Siç e artikulojnë shumë maturantë: *“këshillimi varet nga mësuesi”*.
- Mungesa e koherencës ndër vite vazhdon të krijojë probleme të shumta që nga parapërgatitja e deri te rezultatet e nxënësve. Kjo qëndrueshmëri duhet të reflektohet jo vetëm në programet dhe kurrikulat, por edhe në reformat e ndërmarra. Nuk munguan as këtë vit nxënës të shumtë që iu referuan brezit të tyre si *“brez eksperiment”* apo administratorë që u ankuan për ndryshimet e vazhdueshme¹. Kjo sjell një sërë pasigurish dhe, mbi të gjitha, dëmton legjitimitetin e procesit. Një nga sugjerimet më të përmendura ishte: më pak ndryshime gjatë të njëjtit cikël të shkollës së mesme dhe konsolidimin ndër vite të një sistemi të besueshëm.
- Ekziston një konsensus në pjesën më të madhe të intervistave me nxënës dhe administratorë, që rëndësia kushtuar mesatares (20%) është tejet e ulët. Ky konsensus udhëhiqet nga perceptime se është e padrejtë që puna gjatë gjithë viteve të vlerësohet aq ulët. Vlerësimi i ulët për mesataren e shkollës së mesme është edhe faktori kryesor në inkurajimin e dukurisë shqetësuese të prioritarizimit të lëndëve të MSH-së dhe lënien pas dore të lëndëve të tjera.
- Duke u nisur nga rëndësia që ka nota e MSH-së (në krahasim me mesataren) për pranimin në shkollat e larta, administrimi i provimit merr një rëndësi të veçantë, por duket se këtij procesi nuk i është kushtuar vëmendja dhe serioziteti i nevojshëm, duke qenë se pjesa më e madhe e problemeve raportohen në këtë fazë të procesit.
- Këshillimet falas të ofruara nga shkollat publike nuk kanë mundur të zëvendësojnë kërkesën për kurse private. Disa nga problemet që janë identifikuar në këto këshillime falas janë: 1) ato zhvillohen në grupe relativisht të mëdha dhe koha në dispozicion për nevojat e secilit është e pamjaftueshme; 2) mësuesit nuk janë të motivuar të punojnë jashtë

¹ Intervistë e zhvilluar me AP në Fier.

orarit pasi nuk paguhen për këto këshillime që ofrojnë; 3) orari në të cilin zhvillohet këshillimi, në përgjithësi, është ose shumë herët në mëngjes, ose shumë vonë mbasdite, çka e bën atë të papërshtatshëm për t'u ndjekur nga maturantët.

Administrimi i provimeve

- Studimi ka identifikuar raste kur maturantët janë pranuar në provim edhe pse nuk kanë pasur dokument identifikimi me vete, apo kanë pasur vetëm një fotokopje të dokumentit të identifikimit. Në këto raste është proceduar duke plotësuar një procesverbal nga drejtori i shkollës, i cili garanton identitetin e tij. Një praktikë e tillë konsiderohet delikate, duke qenë se mund të krijojë shteg për abuzime, të cilat do të lejonin hapësira që persona të tjerë të mund t'i nënshtroheshin provimit në emër të dikujt tjetër.
- Është konstatuar se megjithëse në pjesën më të madhe është aplikuar një procedurë e mbledhjes së celularëve, një pjesë e konsiderueshme e maturantëve kanë mundur të komunikojnë përmes celularit (si edhe internetit në celular) me persona të tjerë jashtë mjedisëve të provimit.
- Gjithashtu, pjesa më e madhe e maturantëve, mësuesve, prindërve dhe administratorëve të provimit (AP) kanë deklaruar se gjatë provimeve të MSH-së ka pasur komunikim të vazhdueshëm mes maturantëve në lidhje me zgjidhjen e provimeve. Madje janë raportuar raste kur vetë administratorët, në vend që ta ndalonin këtë fenomen, kanë luajtur rolin e ndihmësit duke kaluar zgjidhjet e ushtrimeve nga një maturant tek tjetri.
- Ka rezultuar se AP-të janë caktuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale (DAR) për të monitoruar provimet e MSH-së në qytetin ku ata banojnë apo ku japin mësim, duke rritur kështu shanset për konfliktin e interesit, sidomos në rastet e qyteteve të vogla. Gjithashtu, ka rezultuar se vetë AP-të nuk shpërblehen për kryerjen e kësaj detyre të vështirë, pasi administrimi i provimeve konsiderohet si një ditë normale pune.
- Përmes metodave cilësore të kërkimit është synuar t'i shkohet në thellësi çështjes së keqadministrimit të provimeve dhe ka rezultuar se shpesh AP-të gjenden në një situatë të vështirë ku nga njëra anë u duhet të përballen me presionin shoqëror, përballë të cilit gjenden të pambrojtur dhe nga ana tjetër nuk kanë asnjë nxitje për të kryer punën e tyre me korrektësi. Në jo pak raste AP-të, por edhe nxënësit, kanë sjellë dëshmi se persona të jashtëm kanë hyrë në mjediset e provimit dhe kanë kërcënuar AP-të duke u kërkuar atyre që të ndihmojnë maturantë të caktuar në provim.
- Është vënë re se, sa i përket abuzimit, ka një qëndrim më rigoroz të AP-ve

kundrejt maturantëve që vijnë nga zonat rurale, duke mos i lejuar ata të kopjojnë, ndërkohë që maturantëve të tjerë të pranishëm (banorë të atij qyteti) u lejohej një veprim i tillë (kopjimi).

- Së fundi, përmes studimit është konstatuar një nivel mjaft i ulët besimi te provimet e MSH-së. Kështu, në jo pak raste ekziston një opinion i përgjithshëm në qytetet ku është zhvilluar studimi, se duke penguar kopjimin gjatë provimeve të MSH-së, AP-të pengojnë shkollimin e maturantëve të atij qyteti, duke qenë se ata do të konkurrojnë me maturantë të qyteteve të tjera, të cilët mund të kenë më shumë shanse për të kopjuar gjatë provimeve të MSH-së.

Vlerësimi i provimeve

- Nuk ka ndonjë informacion se mbi ç’kriete përzgjidhen vlerësuesit e provimeve. Kryesisht rekrutohen të njëjtët vlerësues që e kanë ushtruar këtë detyrë në vitet e kaluara, por nuk është e qartë nëse ekziston një vlerësim i performancës së tyre nga viti në vit.
- Në shumë raste trajnimet për vlerësuesit e provimeve bëhen krejt formale, pasi konsiderohet që vlerësuesit janë me përvojë dhe informacioni i trajtuar në këto trajnime është i njohur prej tyre. Ndërkohë udhëzimet konkrete jepen ditën e parë të vlerësimit të provimeve, duke vonuar kështu fillimin e procesit të vlerësimit dhe për pasojë edhe nxjerrjen e rezultateve.
- Ka dyshime se skema e vlerësimit të dyfishtë në praktikë nuk zbatohet gjithmonë. Studimi ka evidentuar pretendime që në disa raste vlerësuesit i ndajnë me njëri-tjetrin provimet: njëri vlerëson gjysmën e parë të provimeve, ndërsa tjetri gjysmën tjetër dhe në fund vendosin në mënyrë fiktive dy firma.
- Janë konstatuar shpesh gabime në grumbullimin e pikëve dhe hedhjen e tyre në figurat përmbledhëse.
- Nuk ka procedura të qarta dhe as kritere për identifikimin e atyre provimeve ku është kopjuar, duke e lënë këtë detyrë në intuitën e vlerësuesit. Gjithashtu, është e paqartë se si funksionon procesi i vërtetimit të kopjimit nga komisioni KOPOTED (Komision i Possaçëm për Testet e Dyshuara)
- Një pjesë e konsiderueshme e maturantëve dhe mësuesve e konsiderojnë skemën e vlerësimit të Maturës Shtetërore si tepër të komplikuar dhe të paqartë.
- Maturantët ankohen për mungesën e informacionit në vlerësimin e provimeve të tyre, duke mos kuptuar se me sa pikë janë vlerësuar në

secilën përgjigje dhe se ku kanë gabuar.

- Pjesa dërmuese e nxënësve dhe mësuesve deklarojnë se u është mohuar e drejta e ankimit ndaj vlerësimit që u është bërë testeve të tyre në provimet e MSH-së.
- Pjesa dërmuese e maturantëve, mësuesve dhe AP-ve mendojnë se gjatë maturës shtetërore kopjohet, dhe për pasojë ata nuk besojnë se notat e MSH-së pasqyrojnë përgatitjen reale të nxënësve.

Kapitulli

1

**Parapërgatitja
e Maturës
Shtetërore 2012**

SIBORA DHIMA




4. HAPI 1 – PARAPËRGATITJA E MATURËS SHETËRORE 2012

Informacioni mbi provimet e MSH-së

Përgjithësisht, nxënësit paraqiten të qartë për sa i përket informacionit mbi mënyrën e plotësimit të formularëve A1, A2 dhe A3. Nga fokus-grupet me maturantë vihet re edhe një lloj autokritike në lidhje me mbledhjen e informacionit të nevojshëm. Në përgjithësi mbizotëron bindja se informacioni ka qenë në dispozicion dhe i mjaftueshëm për ata nxënës që ishin të interesuar. Interesi i ulët dhe/apo neglizhenca nga ana e nxënësve përmendet si faktor edhe në pjesëmarrjen e ulët në këshillimet parapërgatitore që organizuan shkollat në lidhje me këtë proces.

Ka rezultuar se burim informacioni për maturantët në lidhje me Maturën Shtetërore kanë qenë së pari interneti (faqja e internetit e MASH-it dhe AKP-s), të cilat janë zgjedhur nga 74 % e maturantëve të anketuar. Më pas vjen shkolla (mësuesit dhe drejtorja e shkollës), e zgjedhur nga 6% e maturantëve të anketuar. Ndërkohë e treta renditet media (televizionet dhe gazetatat), e zgjedhur nga 30% e maturantëve të anketuar. Të pyetur përse nuk e preferojnë median për t'u informuar mbi MSH-në, maturantët shprehen se arsyeja kryesore është se ata e konsiderojnë informacionin në media si jo të besueshëm.



Këshillimi për karrierën


Një nga çështjet më delikate për nxënësit në parapërgatitjen për MSH-në ka qenë formula e përlogaritjes së pikëve për pranimin në shkollat e larta, e cila ka përcaktuar shpesh përzgjedhjen e lëndëve për provimet me zgjedhje. Gjatë këshillimeve për plotësimin e formularëve, mësuesit kanë përcjellë edhe informacionin mbi përlogaritjen e pikëve. Megjithatë, paqartësitë, keqinformimet apo ndryshimet në formulë kanë ndikuar në zgjedhjet dhe rezultatet e maturantëve. Ndryshimet në formulë përgjatë vitit 2012 kanë vështirësuar për maturantët planifikimin, si dhe bërjen e zgjedhjeve të duhura. Maturantët nga qytete të ndryshme shprehen se në kohën kur kanë bërë përzgjedhjen e provimeve kanë qenë ende të paqartë mbi formulën e saktë të Maturës Shtetërore (MSH) pasi ka pasur tepër paqartësi në morinë e informacionit që është dhënë gjatë vitit shkollor.

Megjithëse MASH-i prej disa vitesh drejton një program mbi Këshillimin e Karrierës, duket se nga komunitetet shkollore ky këshillim ka mbetur në kuadër të veprimtarisë së Komisioneve Shkollore të Maturës Shtetërore (KSHMSH). Studimi ka konstatuar se përveç informacioneve të përgjithshme nuk ekziston një program i mirëfilltë këshillimi për zgjedhjen e degës apo universitetit. Për sa u përket shkollave, duket se ky këshillim ka qenë më shumë nismë e vetë mësuesve gjatë bashkëbisedimeve me nxënësit sesa i organizuar në seanca konkrete të programuara dhe të mirëstrukturuara. Ndërkohë mësuesit janë konsideruar nga nxënësit si një nga burimet kryesore të informacionit apo këshillimit mbi zgjedhjen për shkollën e lartë dhe janë konsultuar mbi çështje si zgjedhja e degës, perspektiva në tregun e punës, përlogaritja e formulave të ndërlikuara të koeficientëve apo analizimi i shanseve për t'u pranuar në degë të caktuara. Nga anketat online rezulton se 62 % e maturantëve të anketuar deklarojnë se burimi kryesor i informacionit ka qenë mësuesit dhe rrjetet e ndryshme sociale në internet.

Ndërkohë, sa i përket angazhimit të universiteteve, duket se universitetet publike kanë qenë shumë pak aktivë në procesin e këshillimit për karrierën, duke ua lënë skenën kryesisht universiteteve private. Nga studimi rezulton se një burim informacioni mbi shkollat e larta kanë qenë edhe prezantimet e zhvilluara nga universitetet private, pasi 32% e maturantëve të anketuar pohojnë ta kenë marrë informacionin mbi shkollën e lartë nga përfaqësuesit e universiteteve private, e ndjekur kjo nga 18% e maturantëve që pohojnë ta kenë marrë informacionin nga përfaqësues të universiteteve publike.

Vitet e fundit në kuadër të programit të MASH-it “Edukimi për Karrierën” janë integruar lëndë si “Edukimi për Karrierën” për klasën e 11-të dhe të 12-të, lëndë e cila zhvillohet edhe në klasën e 9-të, për të cilat mësuesit shprehen entuziastë se në të ardhmen do të ndihmojnë maturantët në marrjen e vendimit të duhur mbi shkollën e lartë.

Figura 2. Nga e keni marrë ju informacionin mbi shkollën e lartë?



Alterteksti dhe Matura Shtetërore

Duke qenë se maturantët e këtij viti përfaqësonin brezin e parë shkollor, që ka studiuar me tekstet alternative (Altertekst), ky studim ka marrë në shqyrtim edhe ndikimin e kësaj reforme në përgatitjen e nxënësve. Nga studimi ka rezultuar se, megjithëse programi mësimor duhet të jetë i përbashkët për të gjithë shkollat e mesme, maturantët dhe mësuesit janë të mendimit se kjo reformë ka penguar përgatitjen e maturantëve për provimet e MSH-së, duke rritur pasigurinë e tyre në lidhje me pyetjet e provimit. Pjesa dërmuese e maturantëve dhe mësuesve të maturës të intervistuar shprehen se gjatë përgatitjes për provimet e MSH-së ata kanë punuar me tekste të ndryshme nga tekstet e shkollës së tyre, pasi tekstet e shkollës së tyre nuk pasqyronin informacion të plotë lidhur me përgatitjen për provimet e MSH-së. Pohimi i maturantëve (mbas provimeve të MSH-së) se, nëse do të kishin punuar vetëm me tekstet e shkollës së tyre, nuk do të kishin mundur t'u përgjigjeshin disa prej pyetjeve të provimeve të MSH-së, na bën të mendojmë se mungesa e një planifikimi të mirë ka bërë që Alterteksti të kthehet në pengesë për sa i përket përgatitjes së maturantëve.

Gjithashtu, maturantët, por edhe mësuesit e maturës, shprehen se programi mbi të cilin ata përgatiten për provimet e MSH-së vjen shumë vonë, duke mos u lejuar kohë të mjaftueshme për një përgatitje të plotë. Një ankesë e vazhdueshme ka qenë përgatitja për provimin e gjuhë-letërsisë, pasi lista e veprave që duhen mësuar mbërriti me vonë duke mos i lejuar maturantët të përgatiteshin mjaftueshëm.

Prioritarizimi i lëndëve

Nga ky studim është vënë re një dukuri që duket se ka lindur për shkak të mënyrës se si është konceptuar Matura Shtetërore. Bëhet fjalë për lënien pas dore nga ana e nxënësve (por nganjëherë edhe nga ana e mësuesve) të disa lëndëve të caktuara, të cilat nuk jepen në provimet e MSH-së. Duke qenë se maturantët nisin të mendojnë për provimet e MSH-së që në klasën e 10-të, pikërisht në këtë periudhë shumë prej tyre vendosin mbi lëndët ku do të fokusohen gjatë viteve të shkollës së mesme. Kështu, nisur nga pohimet e pjesëmarrësve në fokus-grupe, por dhe intervistat e thelluara, vihet re një shtrirje e dukurisë së prioritarizimit të lëndëve që janë pjesë e provimeve të MSH-së. Kjo dukuri është identifikuar edhe në një studim tjetër (“Monitorimi i Maturës Shtetërore 2011” – E. Shabani dhe J. Aliçka), ku është theksuar tendenca e nxënësve për të lënë pas dore lëndët që nuk do t’i japin provim në MSH dhe për t’u fokusuar te lëndët që do të jenë pjesë e provimeve. Megjithatë, është vënë re se ky nënvlerësim për disa prej lëndëve nxitet edhe nga vetë mësuesit e lëndës, të cilët kanë prirjen të jenë më pak të interesuar për ata nxënës, të cilët nuk do të japin provim në MSH lëndën e tyre (p.sh. mësuesit e Biologjisë e fokusojnë punën e tyre vetëm te nxënësit, të cilët kanë zgjedhur të japin provim Biologjinë, duke mos u kushtuar shumë vëmendje nxënësve të tjerë, apo duke qenë tolerantë në vlerësimin e tyre).


Duke u mbështetur tek të dhënat e studimit mund të hamendësojmë se, veç qasjes individuale të nxënësve, prioritarizimi i lëndëve është edhe një nga efektet anësore të peshës së ulët që i është vendosur mesatares së notave të tri viteve të shkollës së mesme në pikët totale të MSH-së. Duket se pesha e ulët që ka mesatarja e notave të shkollës së mesme (vetëm 20%) nuk mjafton për t’i nxitur nxënësit të angazhohen me të njëjtën shkallë serioziteti për çdo lëndë, por përkundrazi t’u kushtojnë fare pak vëmendje disave prej tyre.

Këshillimet falas të ofruara në shkollat e mesme publike

Duke qenë se MASH-i ka marrë masa për të ofruar në shkollat publike këshillime falas për maturantët, me qëllim uljen e peshës së kurseve private, është monitoruar ecuria e tyre. Nga studimi rezulton se këshillimet falas, megjithëse janë zhvilluar në pjesën më të madhe të shkollave të mesme publike (vetëm 11% e maturantëve të anketuar janë shprehur se këto këshillime nuk janë zhvilluar në shkollën e tyre), ato nuk kanë pasur kudo apo për këdo të njëjtin efekt.

Nga rezultatet e anketës online ka rezultuar se 33 % e maturantëve të anketuar kanë ndjekur vetëm këshillimet falas të organizuara nga shkolla, ndërkohë 34% e

Figura 3. Si do t'i vlerësonit konsultat falas të organizuara nga shkolla
(Përqindja e respondentëve që kanë deklaruar se janë zhvilluar konsulta)




tyre (maturantëve të anketuar) janë shprehur se nuk i kanë ndjekur fare këshillimet falas të organizuara nga shkolla, 21 % e të cilëve janë shprehur se kanë preferuar të përgatiten përmes kurseve private

Një pjesë e konsiderueshme e maturantëve të anketuar shprehen se nuk i kanë preferuar këto këshillime falas. Arsytet që rendisin ata janë të shumta, por kryesisht është mungesa e besimit tek efektiviteti i këtyre këshillimeve, çka vërtetohet nga sondazhi online, ku 45% e maturantëve të anketuar shprehen se nuk i kanë preferuar këto këshillime falas pasi ato janë fiktive. Arsye të tjera që kanë ndikuar në mosndjekjen e këtyre këshillimeve janë:

- Së pari, periudha kur janë zhvilluar këto këshillime (vetëm gjatë muajit maj, shumë pranë periudhës së provimeve të MSH-së) është e vonuar, ndërkohë që maturantët i kanë filluar përgatitjet e tyre shumë kohë më parë.
- Së dyti, për shkak të orës së papërshtatshme kur zhvillohen këto kurse (ose shumë herët në mëngjes ose shumë vonë mbasdite).
- Së treti, koha në dispozicion për seancat e këshillimit ka qenë tepër e shkurtër. Duke qenë se ato zhvilloheshin me grupe të mëdha nxënësish, nuk kishte kohë të mjaftueshme që mësuesit t'i kushtoheshin secilit (ndryshe nga ç'ndodh kryesisht në kurset private).

Kështu shpesh është vënë re se këto këshillime u kanë shërbyer më shumë nxënësve të përgatitur, ngaqë janë përqendruar vetëm në trajtimin e ushtrimeve të përparuara, duke u kushtuar më pak kohë vështirësive apo mangësive në përgatitje të nxënësve të tjerë.




Paçka se mësuesit shprehen pozitivisht për këshillimet falas duke raportuar se ato përgjithësisht u kanë ardhur në ndihmë nxënësve që i kanë ndjekur dhe janë reflektuar në nota më të larta në krahasim me notat e nxënësve që nuk i kanë ndjekur, sërish ata (mësuesit) ankohen se nuk kanë asnjë nxitje apo shpërblim në lidhje me këto këshillime. Kështu, është raportuar se këto këshillime për maturantët, megjithëse bëhen mbi ngarkesën normale mësimore të mësuesve, nuk shpërblehen financiarisht, duke mos u llogaritur si orë shtesë.

Nisur nga problemet e identifikuara më sipër, këshillimet falas vlerësohen pozitivisht vetëm nga 44% e maturantëve që i kanë ndjekur ato. Pjesa tjetër i konsideron ato si deri diku të dobishme (37 %) dhe pak ose aspak të dobishme (19 %).

Megjithëse rastet pozitive të mësuesve të përkushtuar, që kanë zhvilluar këshillime tepër cilësore, e kanë ulur nevojën për kurse private, në një këndvështrim të përgjithshëm mund të themi se këshillimet falas nuk kanë mundur të minimizojnë kërkesën për zhvillimin e kurseve private. Këto këshillime falas, edhe në rastet kur janë zhvilluar, kanë shërbyer kryesisht si ndihmë shtesë në përgatitjen e maturantëve për provimet e MSH-së, çka mbështetet edhe nga rezultatet e anketës online, ku 27 % e maturantëve që deklarojnë se kanë ndjekur këto këshillime falas, pohojnë se kanë ndjekur, gjithashtu, edhe kurse private.

Figura 5. Përse nuk keni ndjekur konsultat falas të ofruara nga shkolla?



Së fundi, duam të theksojmë se mungesa e besimit të ndershmëria e procesit, ka bërë që një pjesë e maturantëve të mos përgatiten për provimet e MSH-së, duke shprehur të shfrytëzojnë keqmenaxhimin e këtyre provimeve për të kopjuar.

Kurset private

Megjithëse prej kohësh MASH-i ka marrë disa masa, siç janë këshillimet e falas të përmendura më sipër apo udhëzimi për qëndrimin me orar të zgjatur të çdo mësuesi, në mënyrë që t'u përgjigjet pyetjeve të maturantëve, duke vendosur mbajtjen hapur të shkollës deri në orën 18:00, sërish maturantët në një shkallë të lartë kanë deklaruar se për t'u përgatitur për MSH-në u është dashur të ndjekin kurse private. Lënda kryesore për zhvillimin e kurseve është Matematika, që, me sa duket, paraqet vështirësi për maturantët, por nuk mbesin mbrapa edhe lëndë të tjera. Për sa u përket mësuesve me të cilët maturantët i zhvillojnë këto kurse, shpesh raportohet që ata të jenë mësuesit e shkollës, madje në jo pak raste janë mësuesit e tyre të lëndës, praktikë kjo e ndaluar ligjërisht nga MASH-i.

Sipas anketave të zhvilluara online në lidhje me konsultat falas dhe kurset private rezulton se:

- 21% e respondentëve kanë ndjekur kurse private si përgatitje për MSH-në, ndërkohë që 27% i kanë ndjekur edhe kurset private, edhe konsultat në shkolla. Pra, rreth 48% e respondentëve kanë frekuentuar kurse private.

Përmbajtja e testeve të MSH-së

Në lidhje me nivelin e vështirësisë së testeve, mësuesit dhe nxënësit bien dakord se, në përgjithësi, provimet i janë përmbajtur programit dhe janë cilësuar si të përshtatshme për nga niveli i vështirësisë, megjithatë nuk kanë munguar edhe rastet kur maturantët në të gjitha qytetet kanë sjellë raste pyetjesh, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në programin përgatitor² të miratuar nga MASH-i, me të cilin janë përgatitur maturantët.

Përzgjedhja dhe trajnimi i administratorëve të provimeve të MSH-së

Ashtu siç parashikon Rregullorja e MSH-së, përzgjedhja e administratorëve të provimit (AP) dhe e përgjegjësit të administrimit të provimit (PAP) është bërë nga Drejtoria Arsimore Rajonale (DAR) dhe drejtoria e shkollës. Për sa u përket kandidaturave rezulton se drejtorët e shkollave përkatëse kanë propozuar ata mësues që i kanë gjykuar si më të përshtatshëm. Ndërkohë që është vënë re një tendencë e përgjithshme për të emëruar AP të njëjtët persona që e kanë kryer këtë detyrë edhe në vitet e mëparshme, duke u bazuar në argumentimin se këta persona kanë më tepër përvojë dhe për rrjedhojë nuk ka rezultuar të jenë përdorur kritere të tjera të përcaktuara më parë mbi kualifikimet dhe aftësitë që duhet të përmbushë secili kandidat për AP apo PAP. Nga ana tjetër vlen për t'u theksuar se vetë mësuesit që janë caktuar si AP nuk kanë pasur zë në këtë proces, duke e konsideruar këtë emërim si *“një urdhër të ardhur nga lart”*. Për pasojë as vetë AP-të nuk e kanë të qartë se mbi ç’kritere janë përzgjedhur për të kryer këtë detyrë.

Ndërkohë përveç faktit se në Rregulloren e MSH-së nuk janë të qarta as kriteret dhe as procedura e zgjedhjes së AP dhe PAP, kjo rregullore nuk ka arritur të interpretojë në mënyrë të mjaftueshme konfliktin e interesit. Kështu në Rregullore ndalohet vetëm që AP të jetë mësues i të njëjtës lëndë me provimin që po mbikqyr, apo që ai të mos ketë asnjë familjar që të jetë maturant i atij viti. Ndërkohë që në qytete tepër të vogla, konflikti i interesit do të mund të interpretohej edhe në pengimin për të mbikqyrur nxënësit e të njëjtit qytet ku ai mësues jeton apo punon. Një pengesë e tillë në mënyrë eksplicite ka bërë që shpesh mësuesit të emërohen AP në qytetin e tyre, madje (në disa raste) edhe në shkollën ku ata japin mësim. Një gjë e tillë i ka vendosur AP-të në një presion shumë të madh social si përballë të njohurve të tyre, ashtu edhe përballë fëmijëve të personave me influencë në komunitet apo edhe komunitetit të prindërve në përgjithësi, të cilët jo rrallë e shohin privimin

² Një shembull i sjellë në çdo fokus-grup me maturantë ishte poezia “Albatros” e Sharl Bodler

nga kopjimi si një padrejtësi që u bëhet maturantëve të atij qyteti krahasuar me maturantët nga qytete të tjera, që, duke pasur mundësi të kopjojnë, mund të arrijnë rezultate më të larta. Një qëndrim i tillë vjen kryesisht edhe nga mungesa e besimit që shfaq komuniteti ndaj mënyrës se si administrohen provimet e MSH-së në të gjithë vendin, por edhe nga niveli i ulët i ndërgjegjësimit përballë kopjimit, si një fenomen që bie ndesh me vlerat morale të ndershmërisë në konkurrim. Gjatë këtij studimi janë raportuar vazhdimisht raste të kërcënimeve ndaj AP-ve, raste kur AP-të janë shoqëruar në shtëpi nga furgona të policisë sepse *“jashtë i prisnin një grup prindërisht që i kishin kërcënuar se do t’i rrihnin, do t’i qëllonin dhe ulërinin me lloj-lloj fjalësh [...] sepse nuk i kishin lënë femijët e tyre të kopjonin në provimet e MSH-së”*³, apo raste kur vetë nxënësit apo prindërit e tyre kanë kërcënuar AP-të, si dhe shumë e shumë raste të tjera kërcënimesh dhe abuzimesh.

Së fundi, duhet theksuar se puna e AP-ve në mbikqyrje të provimeve, krahas rreziqeve dhe presionit që mbart, nuk shpërblehet as financiarisht dhe as me promovim në karrierë, duke bërë që motivimi i AP-ve për të kryer me korrektësi detyrën e tyre të jetë shpesh tepër i ulët. Një shpërblim, gjithsesi i ulët, raportohet të jetë dhënë vetëm për PAP-ët dhe vetëm në ato raste kur provimi qëllon në ditë pushimi.

Për sa i përket trajnimit të administratorëve, në të shumtën e rasteve është raportuar se janë zhvilluar takime ku janë dhënë këshilla të përgjithshme (të tipit “siç keni bërë vjet, do bëni edhe sivjet”), por jo trajnime të mirëfillta. Disa nga AP-të më të vjetër raportojnë se trajnimin e fundit të mirëfilltë e kanë marrë vite më parë nga stafi i drejtorive arsimore, ndërsa trajnimet/takimet gjatë viti 2012 janë zhvilluar në grupe shumë të mëdha (150–200 mësues njëherësh) në një kohëzgjatje prej rreth 40 minutash. Përveç faktit se AP-të e rinj e kanë akoma më të nevojshme trajnimin, gjithashtu, vlerësohet se edhe për AP-të që kanë më tepër eksperiencë nevojitet trajnimi dhe udhëzimi në lidhje me ndryshimet që pëson MSH çdo vit. Kështu gjykojmë se, nëse disa çështje specifike të administrimit (si ekzistenca dhe shpërndarja e tezave të përshtatura për programet e ndryshme të studimit) do të kishin marrë më tepër vëmendje gjatë këtyre takimeve/trajnimeve, një pjesë e problemeve të konstatuara gjatë administrimit mund të ishin shmangur.

Administratorët nuk kanë pasur manual udhëzues me shkrim, por rekomandime me gojë dhe printime të rregullave në formën e 10–15 pikave kyçe kryesisht të përqendruara te masat e sigurisë dhe veprimet e ndaluara.

3 Fier Aida matura mësues

Në përgjithësi, duke qenë se shqetësimi kryesor është minimizimi i çdo lloj mundësie për të kopjuar gjatë provimeve të MSH-së, në kuadrin rregullues të MSH, pak hapësirë u është lënë të drejtave të maturantit. Kështu, shpesh AP-të, në varësi të shkallës së ndërgjegjësimit, mund të tolerojnë sjellje të caktuara, si p.sh.: mbajtjen e ujit gjatë provimit apo të lejojnë vajtjen e maturantit në tualet (i shoqëruar nga një AP), edhe pse këto sjellje nuk parashikohen nga Rregullorja e MSH-së. Në një situatë të tillë, ku të drejtat e maturantëve nuk merren parasysh nga Rregullorja e MSH-së, roli i AP-ve bëhet tepër i gjërë për t'u mohuar ose jo të drejta të tilla themelore.

Për sa i përket penalizimit të AP-ve, masat sipas rregullores janë “paralajmërim për largim nga puna”, që pasqyrohet në dosjen personale ose “largim nga puna”, që pasqyrohet në librezën e punës. Megjithatë duhet theksuar se, megjithëse keqadministrim raportohet pothuajse në pjesën më të madhe të shkollave, rastet e ndëshkimit të AP-ve, PAP-ve apo personave të tjerë përgjegjës janë jashtëzakonisht të rralla.

Kapitulli

2

**Administrimi
i provimeve
të Maturës
Shtetërore 2012**

AURON PASHA



5. HAPI 2 – ADMINISTRIMI I PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2012

Mjediset e provimit

Megjithëse Rregullorja e MSH-së përcakton se mjediset e provimit duhet të jenë të ndriçuara dhe të ajrosura, duket se kjo nuk ka ndodhur në të gjitha rastet. Kështu shpesh maturanët shfaqin pakënaqësi në lidhje me ambientet ku është zhvilluar provimi, sidomos në ato raste kur ai është zhvilluar në menca, korridore apo palestra, ku ndriçimi dhe ajrosja ka qenë e vështirë.

Ora e fillimit të provimit

Maturanët u pyetën edhe në lidhje me orarin e provimeve. Rreth 20% e maturanëve të pyetur u përgjigjën se provimi (të paktën njëri prej provimeve) ka filluar të paktën 30 minuta me vonesë. Kjo do të thotë që ende një pjesë e konsiderueshme maturanësh përballen me çështjen e nisjes së provimit me vonesë. Ky problem është identifikuar edhe gjatë fokus-grupeve, ku pjesëmarrës të shumtë janë ankuar në lidhje me këtë dukuri, sidomos sa i përket provimit të lëndëve me zgjedhje. Në këto provime në rrethe të ndryshme janë ankuar pasi ka pasur vonesa dhe tezat kanë ardhur me vonesë ose janë ngatërruar. Në disa raste ka ndodhur që edhe pse provimi ka nisur me vonesë, orari i mbylljes së provimit ka mbetur i pandryshuar (ora 13:00) dhe maturanët nuk kanë pasur të gjithë kohën e nevojshme në dispozicion për të zhvilluar pyetjet e provimit.

Identifikimi i Maturanëve

Një element tjetër procedural për të cilin shprehet rregullorja e MSH-së është identifikimi i maturanëve që hyjnë në provim. Të anketuarit u pyetën nëse në dijeninë e tyre ka pasur maturanë që janë futur në provim pa pasur një dokument të saktë identifikimi. Më shumë se një në tre të pyetur (36%) shprehet se është në dijeni të një rasti të tillë. Shqetësuese të përgjigjet është se vetëm 4% shprehen se këta persona nuk u lejuan të futen në provim, ndërkohë që 32% shprehen se maturanët pa dokumentin e specifikuar të identifikimit u lejuan të futeshin në provim. Rreth 18% e maturanëve të pyetur deklarojnë se këta persona janë identifikuar nga drejtori i shkollës, 9% janë shprehur se personat kanë sjellë një fotokopje të certifikatës (jo certifikatë origjinale) dhe 5% shprehen se këta persona thjesht janë futur në provim pa problem.

Në përgjithësi, duke gjykuar edhe nga diskutimet në fokus-grupe, duket se vetë maturanët nuk janë të ndërgjegjësuar për rrezikshmëritë e këtij fenomeni. Shpesh ata shprehen se “dikush që ka harruar kartën e identitetit, duhet lejuar të hyjë për sa kohë mësuesit e njohin”. Por integriteti i procesit të maturës vihet në pikëpyetje, pasi mos -respektimi i kësaj procedure (identifikimi i maturanëve) përveç se mund të krijojë hapësira për mashtrim me identitetin, krijon premisa për moszbatim (apo lëshim) edhe të rregullave të tjera gjatë procesit. Në vetvete, serioziteti i procesit vihet në pikëpyetje që në procedurën hapëse të tij.


Shpërndarja e tezave

Vonesa të shumta u raportuan nga maturanët edhe në lidhje me shpërndarjen e tezave. Një vonesë e tillë mund të ketë ndodhur si pasojë e masave të sigurisë, siç mund të jetë rregulli që tezat të transportohen ditën e provimit, apo mund të jenë shkaktuar për shkak të problemeve me organizimin, të cilat kanë qenë edhe më të dukshme në rastet e provimeve me zgjedhje. Kështu gjatë fokus-grupeve, një sërë maturanësh raportuan se kishin marrë teza, të cilat, edhe pse ishin të lëndëve që ata kishin zgjedhur, ishin hartuar mbi programe të tjera e jo mbi programin e tyre; apo janë raportuar dhe raste kur ata kanë marrë tezën e një lënde që nuk kishte lidhje me lëndën e zgjedhur prej maturanit. Një gjë e tillë ka rezultuar të ketë qenë gabim në shpërndarje nga ana e personave përgjegjës për këtë proces si PAP, AP dhe AS. Për shembull, megjithëse Rregullorja e MSH-së parashikon që për programe të ndryshme studimi përgatiten teza të ndryshme, në Elbasan maturanët që kishin studiuar në programin dy-gjuhësh (një program i veçantë ky) kanë marrë gabimisht teza të programit të përgjithshëm. Apo raste ku maturanët kanë dhënë në provim Qytetarinë, ndërkohë që kishin zgjedhur Sociologjinë etj. Ky fenomen ka ndikuar në administrimin e procesit pasi ka sjellë shpesh vonesa, por edhe ankesa nga maturanët. Sidomos në rastet kur disa prej maturanëve, duke mos e konstatuar në kohë ngatërresën, kanë punuar me tezën e gabuar duke arritur rezultate më të ulta se ç’mund të kishin arritur nëse do të punonin me tezën për të cilën ishin përgatitur. Një dukuri e tillë ngre pikëpyetje mbi marrjen e masave parapërgatitore nga ana e stafit përgjegjës për administrimin e MSH-së.

Përdorimi i celularëve

Një nga mënyrat më të zakonshme të përdorura për kopjim/komunikim gjatë zhvillimit të provimeve të MSH-së është përdorimi i celularit. Sipas Rregullores, përdorimi i celularit është i ndaluar kategorikisht nga maturanët. Nga pikëpamja administrative, gjatë hyrjes në provim, maturanët i nënshtrohen një procesi të

dorëzimit të celularëve tek administratori i provimit (AP). Ky fakt pohohet të ketë ndodhur nga 86% e maturantëve të anketuar. Por 14% e maturantëve që deklarojnë se një proces i tillë i dorëzimit të celularëve nuk u krye, përbëjnë gjithësesi një numër shqetësues.



Diskutimet në fokus-grupe konfirmuan që jo vetëm kishte raste kur kontrolli për celularë nuk bëhej, por edhe atëherë kur bëhej ishte shumë formal dhe sipërfaqësor. Maturantët në focus-grupe tregojnë se shumë persona kanë vajtur me dy celularë dhe ndërkohë që e kanë dorëzuar njërën, tjetrin e kanë mbajtur me vete gjatë gjithë provimit.

“Te ne kontrolli nuk ishte aq rigoroz, me thënë të drejtën, jo edhe aq i rreptë. Thjesht ke telefon, s’ke telefon. Mund ta kishe fshehur në çdo lloj vendi telefonin dhe thjesht të pyesnin ke telefon, s’ke telefon. Nnëse e dorëzoje, ok, tregojë.”

MATURANT, ELBASAN.

“Jo, në shkollë nuk kontrollohet, thjesht të thonë “dorëzoje celularin” pastaj lart është punë e tij nëse e mban apo jo... Edhe lart mesuesi të thotë: kush ka celular ta dorëzojë, por (nuk ka kontrolle)”


MATURANTE, FIER

Persona të paautorizuar

Rreth 28% e të anketuarve pohojnë se kanë vënë re persona të tjerë, përveç maturanëve dhe mësuesve/administratorëve, në ambientet ku zhvillohej provimi i MSH-së. Nga këta maturanët që pohojnë se kanë parë persona të tjerë, 53% shprehen se këta persona kanë qenë familjarë dhe të afërm të maturanëve. E projektuar mbi të gjithë kampionin e anketuar, kjo do të thotë se rreth 12% e maturanëve pohojnë se kanë parë familjarë dhe të afërm të atyre që po kryenin provimin, brenda ambienteve ku po zhvillohej provimi. Ndërsa 38% e këtyre maturanëve, që kanë deklaruar se kanë parë persona të tjerë brenda ambienteve të provimit, sqarojnë se kanë parë drejtorin e shkollës; ndërsa 18% e tyre deklarojnë të kenë parë punonjësit e policisë.

Rregullorja e MSH-së e ndalon pjesëmarrjen e personave të tjerë të paautorizuar në mjediset e brendshme të provimit, pasi mund të ndikojë drejtpërdrejt në proces. Maturanët e anketuar u pyetën më tej se si vepruan këta persona të paautorizuar gjatë kohës që ndodheshin në sallën e provimit. Rreth 69% e atyre që pohuan se kanë parë persona të tjerë në mjediset e provimit, deklarojnë se këta persona komunikuan me apo ndihmuan një apo më shumë maturanë. Kur projektohet mbi të gjithë kampionin, kjo shifër përkthehet në 18% e të gjithë maturanëve të anketuar që deklarojnë se persona të paautorizuar kanë komunikuar dhe ndihmuar maturanë të tjerë gjatë provimit. Duke studiuar përgjigjet e pyetjeve të dhëna në të gjithë këtë seksion, del se në procesin e komunikimit/ndihmimit të maturanëve gjatë provimit nuk janë përfshirë vetëm familjarët dhe të afërmit e maturanëve të vënë re në mjedise, por edhe drejtorët e shkollës apo punonjësit e policisë. Fakti që përqindja e atyre të anketuarve (18%) që deshmojnë komunikimin apo ndihmesën e dhënë maturanëve nga persona të jashtëm është më i madh se përqindja e atyre që deklarojnë prezencën e familjarëve

Figura 7. Kë patë në ambientet e brendshme të provimit



në mjedise (12%) tregon se diferenca duhet të ketë ardhur nga drejtorët e shkollave apo nga punonjësit e policisë prezentë në këto mjedise ku zhvillohej provimi. Gjatë diskutimeve në fokus-grupe me maturantë, rezultoi e njëjta situatë: me shumë diskutantë që konfirmonin prezencën e personave të paautorizuar në mjediset e provimit.

“Po, ka pasur, prindër. Përveç Drejtorisë Arsimore, që vinte për kontroll, se është detyra e saj të shkojë në çdo shkollë për të vënë re zhvillimin e ngjarjes, unë pashë edhe prindër. Prindër që ishin të stafit pedagogjik të shkollës sime, që absolutisht nuk u takonte se ishin me statusin prind dhe jo mësues. Edhe mësues po të ishte, nuk duhej të lejohe. Ata vinin aty për të parë ndonjë të njohur”.

MATURANTE, VLORE.


“Kishte prindër që vinin në klasa dhe komunikonin, jepnin zgjidhjet e ushtrimeve. Teza e matematikës doli jashtë shkolle dhe zgjidhjet hynë në shkollë...”

MATURANT, VLORE

Kopjimi gjatë zhvillimit të provimit

Dukuria e kopjimit në provimin e maturës sipas përgjigjeve të të anketuarve është gjerësisht e përhapur. Rreth 62% e të anketuarve deklarojnë se sipas mendimit të tyre në provimin e maturës është kopjuar. Edhe sikur të jetë më shumë perceptim sesa fakt, një shifër e tillë shqetësuese minon drejtpërsëdrejti besimin në proces dhe e njollos integritetin e tij.

Figura 8. Sipas mendimit tuaj, a u kopjua gjatë MSh?



Maturantët specifikojnë më tej ato që kanë vënë re gjatë procesit të provimit në lidhje me mundësitë për të kopjuar. Më shumë se gjysma e maturantëve të anketuar (56%) deklarojnë se kanë vënë re komunikim midis maturantëve gjatë provimeve të MSH-së. Rreth 45% e tyre deklarojnë se kanë vërejtur komunikim midis maturantëve dhe AP-ve gjatë provimit. Në të njëjtën linjë, por edhe më shqetësues, është fakti se 43% e maturantëve të anketuar deklarojnë se kanë vënë re komunikim mes maturantëve dhe personave të jashtëm, ose drejtëpërdrejt, ose nëpërmjet celularit (mesazhe apo internet). Mesatarisht kjo do të thotë që rreth 48% e maturantëve kanë vënë re një komunikim gjatë procesit të provimeve të MSH-së, i cili është bërë në shkelje të Rregullores së MSH-së dhe që ka gjasa të mëdha të ketë rezultuar në ndihmë të maturantëve të caktuar për të zgjidhur pyetjet e provimeve.

Mbi këtë çështje është hulumtuar më tej gjatë fokus-grupeve, ku maturantët pjesëmarrës kanë konfirmuar gjetjet e sondazhit online përmes ilustrimeve me shembuj ku ata vetë kanë qenë dëshmitarë. Kështu, megjithëse nuk përjashtohen rastet kur AP-të kanë mbajtur një qëndrim korrekt, në një pjesë të madhe raportohet për AP të cilët kanë lejuar kopjimin gjatë provimeve të MSH-së, ku në shumë raste edhe e kanë ndihmuar atë.

“Po, sepse kishte raste, p.sh. kopje, kur normalisht vëzhguesja bërtiste dhe thoshte që po vjen inspektori apo ku ta di unë se kush ishte, ndoshta pjesa tjetër që e kontrollonte atë. Idea ishte që të fshihnim kopjet. Kishin edhe ata hallin e vet se normalisht i kapnin ata të tjerët me provimet me kopje.”

MATURANT, ELBASAN

“Te klasa ime për shembull vetëm në provimin e matematikës u la të kopjohej brenda për brenda klasës. Në provimet e tjera fare, nuk e di si për drej qëllonte që vinte ai administratori i madh dhe nuk u bë... u mundua profesorja, merrte nga nxënësi i parë, ai i miri dhe ia shpërndante gjithë klasës.”

MATURANTE, FIER

“...te ne vinin dhe pyesnin çfarë nxënëse je ti, për shembull. Çfarë e ke nxjerrë ti lëndën? Dhe po të thoshe dhjetë ose nëntë, mirë, të thoshte, m'i jep pak pyetjet.”

MATURANTE ELBASAN.


“Komunikimi ishte shumë masiv dhe ekzistonin dy variante për secilën tezë dhe variantet ishin të njëjtat pyetje, por në rend të ngatërruar dhe duhej shumë kohë për ta gjetur. Gjashtën si e ke bërë, po kush është gjashta? Po unë e kam dhjetë atë. Zhurmë e madhe... teza që lëviznin nga banka në bankë...”

MATURANT, VLORE

“Gjatë provimeve me zgjedhje ka pasur edhe raste kur kanë ndërruar teste, kur nxënësit flisnin në celular, edhe me kufje. Ndërroreshin teste. Vinte administratori, merrte testin tim dhe ia shpinte një tjetri.”

MATURANT, KORÇE

Figura 9. Koha në dispozicion për provimet



Koha në dispozicion

Pjesa më e madhe e maturantëve të anketuar shprehen se koha në dispozicion për provimin ka qenë “plotësisht e mjaftueshme” (37 %) ose “deri diku e mjaftueshme” (41%). Vetëm 14% e tyre shprehen se koha nuk ka qenë e mjaftueshme. Vlerësimi për mjaftueshmërinë e kohës ka të bëjë edhe me faktin nëse provimi filloi në kohë apo jo (shih më lart). Përgjithësisht, oraret e dorëzimit të provimeve nuk kanë lëvizuar (sipas asaj që është raportuar në fokus-grupe), madje edhe në rastet kur provimet kanë filluar me vonesë 30 deri në 90 minuta (sidomos rastet e provimeve me zgjedhje).

Vlerësimi për administratorët e provimeve (AP)

Maturantët e anketuar u pyetën në lidhje me vlerësimin që do t’u jepnin me notë administratorëve të provimit. Vlerësimi që u jepet AP-ve për të tri provimet është nota 7. Ky është një vlerësim mesatar dhe parë nga sytë e vetë maturantëve, tregon që administratorët nuk janë në nivelin e kërkuar. Përgjithësisht edhe në grupet e diskutimit, roli i AP-ve nuk është përshkruar si rigoroz dhe në respekt të standardeve të vendosura për zhvillimin e një procesi me integritet. AP-të në disa raste kanë kryer rolin e “korrierit” të përgjigjeve nga nxënësit e mirë tek ata më të dobët ose tek ata që kanë pasur njohje. Në një situatë të tillë, kur vetë administratori apo vëzhguesi merr këtë rol, është shumë e vështirë që të kërkohej llogari për çdo sjellje devijante që mund të kryhet edhe nga maturantët e tjerë të pranishëm në provim.

“Edhe mua më vinin dhe më thonin: vazhdo puno, vazhdo puno. Çfarë varianti je ti? Çfarë e ke nxjerrë matematikën? Mirë, më thoshte mua, puno dhe i shënonte në façoleta apo në letra. Do t’ia jap një çikë asaj, se është gjynah e shkreta, e nxjerr gjashtë dhe do të vazhdojë për këtë. Ç’më duhej mua...”

MATURANTE ELBASAN

“...të vinin me emër, unë nuk i njihja fare, të vinin me emër. Ma bëj këtë ushtrimin kështu, unë kisha ngelur në një tjetër. Po e bëre këtë, do të sjell këtë... administratorët vetë”

MATURANT, KORÇË

Kapitulli

3

Vlerësimi, rezultatet dhe legjitimiteti i vlerësimit

ENDRIT SHABANI



6. VLERËSIMI, REZULTATET DHE LEGJITIMITETI I VLERËSIMIT

Procesi i vlerësimit të provimeve

Vlerësimi i provimeve të Maturës Shtetërore rregulloret me akte nënligjore (Rregullorja e Maturës Shtetërore dhe Udhëzimi i Ministrit nr.17, datë 5.5.2011). Sipas dispozitave të akteve të mësipërme, për vlerësimin e provimeve të Maturës Shtetërore ngrihen 6 qendra vlerësimi, 2 në Tiranë, një në Fier, një në Korçë, një në Shkodër dhe një në Elbasan. Pas çdo provimi të MSH-së, në secilën prej qendrave ngrihen grupet e administrimit dhe monitorimit të provimeve. Bazuar në Rregulloren e MSH (neni 58), çdo përgjigje e testit i nënshtrohet vlerësimi të dyfishtë nga dy vlerësues të pavarur nga njëri-tjetri.

Vlerësuesit janë mësues të lëndëve përkatëse, të cilët sipas udhëzimit të Ministrit nr.17 përzgjidhen nga AKP-ja, por që gjatë intervistave rezulton se ata vetë janë pak të informuar se kush i ka zgjedhur dhe mbi ç'kriterë është mbështetur përzgjedhja e tyre. Për sa u përket kriterëve dhe procesit të përzgjedhjes kjo mbetet e paqartë edhe për grupin e ekspertëve, duke qenë se kjo çështje nuk është e rregulluar as nga pikëpamja formale. Megjithëse duket se ka një tendencë për të riangazhuar në vlerësim të njëjtët vlerësues nga viti në vit, duket se nuk ekziston ndonjë proces vlerësimi i performancës së secilit vlerësues, në mënyrë që riangazhimi në këtë detyrë të jetë i bazuar mbi këtë vlerësim. Ndërkohë nga grupet e interesit janë ngritur shpesh dyshime për një përzgjedhje klienteliste të vlerësuesve të provimeve, duke qenë se kjo punë shpërblehet ekonomikisht, çka mund ta bënte të lakmueshme.

Nga intervistat me vlerësuesit e provimeve rezulton se, megjithëse trajnimet për vlerësimin janë zhvilluar, siç parashikon edhe udhëzimi i Ministrit, shpesh këto trajnime kanë qenë formale⁴ duke mos u kushtuar ndoshta vëmendjen e nevojshme problematikave të raportuara dhe nevojës për të përmirësuar skemën e vlerësimit nga viti në vit.

Për sa i përket skemës së vlerësimit të dyfishtë ajo bazohet në Rregulloren e Maturës shtetërore, si edhe në urdhrin e ministrit të Arsimit. Ajo funksionon pak a shumë njëlloj në të gjitha qendrat e vlerësimit të ngritura në disa qytete të Shqipërisë: vlerësuesit e provimeve ndahen në dy grupe (rreth 15 vlerësues për

4 Intervistë me Vlerësues Provimi në Tiranë "Trajnimi është bërë. Na mblodhën dhe na thanë:- Do korrigjoni siç keni bërë vjet"

grup) dhe secili prej grupeve monitorohet prej një përgjegjësi grupi. Secili prej vlerësuesve vlerëson 25–30 provime në ditë dhe shënon në mënyrë të pavarur pikët në një fletë të veçantë. Më pas këto provime vlerësohen nga një vlerësues tjetër, i cili, gjithashtu, bën shënimet e vlerësimit në fletën përkatëse. Në fund të ditës të dy vlerësuesit bashkohen dhe rakordojnë me njëri-tjetrin pikët e vlerësimit. Në rast se ka mospërputhje në vlerësim, fillimisht vlerësuesit diskutojnë me njëri-tjetrin për të gjetur një vlerësim të përbashkët. Vlerësuesit e intervistuar raportojnë se në rast se dy vlerësuesit nuk bien dakord apo diferenca mes vlerësimeve është e madhe, çështja zgjidhet nga përgjegjësi i grupit, i cili, siç duket, ka të drejtën për të vendosur vlerësimin përfundimtar. Për të shmangur mundësitë e mundshme të ndikimeve në vlerësim, AVA vendos numra romakë në çdo provim, duke fshehur barkodin, dhe nga ana tjetër vlerësuesve nuk u bëhet me dije se provimet e cilit qytet janë duke vlerësuar.

Megjithëse në pamje të parë kjo skemë vlerësimi duket e rregulluar mirë, gjatë fokus- grupeve dhe intervistave të zhvilluara në kuadër të këtij studimi, janë raportuar shpesh shqetësime mbi funksionimin në realitet të skemës së vlerësimit. Maturantët në disa fokus-grupe ngrenë dyshime se vlerësuesit i ndajnë me njëri-tjetrin provimet, duke bërë që njëri të vlerësojë gjysmën e provimeve, ndërsa tjetri gjysmën tjetër. Nëse një gjë e tillë ndodh, atëherë në fund secili provim do të vlerësohet nga një njeri i vetëm, paqka se për të kanë firmosur dy vlerësues. Kjo gjë nuk pranohet hapur nga vlerësuesit e intervistuar, por gjatë intervistës, njëri prej vlerësuesve u shpreh se si çift vlerësuesish ata kishin vlerësuar 50 provime në ditë ndërsa veç e veç nga 25 provime secili⁵, ndërkohë që norma e përcaktuar mbi bazën e të cilës është llogaritur pagesa ka qenë 50 provime për vlerësues (100 provime një çift vlerësuesish). Pohime të tilla, të cilat mbështesin dyshimet e ngritura shpesh nga grupet e interesit, rrisin dyshimin se në jo pak raste mund të ndodhë që të mos kemi një vlerësim të dyfishtë, çka do të rriste shkallën e subjektivitetit të vlerësimit (sidomos në pyetjet e hapura), si edhe do të rriste mundësitë për më shumë gabime gjatë vlerësimit.

Ndërkohë edhe në rastet kur skema mund të funksionojë plotësisht, sipas vlerësuesve të intervistuar, ata duke qenë nën trysninë e të mbaruarit të punës sa më shpejt, shpesh bien dakord lehtësisht me njëri-tjetrin për vlerësimet (pra lënë në fuqi vlerësimin që ka bërë kolegu) dhe vetëm në raste të rralla i drejtohen

5 Intervistë me Vlerësues Provimi.

Intervistuesi: Sa provime në ditë keni vlerësuar?

Vlerësues Provimi: “25 provime unë, 25 provime partneri venin 50 provime të korrigjuara në ditë”

përgjegjësit të grupit për të vendosur midis dy vlerësimeve.

Një shqetësim tjetër i evidentuar nga ky studim është edhe procesi i hedhjes së pikëve nëpër figurat përmbledhëse. Vlerësuesit e intervistuar shprehen se të gjitha figurat përmbledhëse të pikëve kontrollohen prej përgjegjësit të grupit dhe në rastet kur vërehen gabime, këto gabime korrigjohen. Megjithatë ata pranojnë se çdo vit kanë ndodhur vazhdimisht gabime në hedhjen e pikëve, gjë e cila dëmton procesin e vlerësimit të drejtë të maturantit. Megjithëse vlerësuesit shprehen se gabime të tilla ndodhin për shkak të lodhjes nga puna, kur janë pyetur mbi ngarkesën, ata shprehen se punojnë rreth 8 orë në ditë gjatë ditëve të vlerësimit dhe se për ta kjo ngarkesë është krejt e përballueshme.

Për sa i përket motivimit të vlerësuesve për të vlerësuar provimet, megjithëse udhëzimi i ministrit parashikon shpërblimin financiar, nuk është e qartë sa është ky shpërblim dhe nëse kjo mjafton për të motivuar financiarisht vlerësuesit e provimeve. Këta të fundit ankohen se jo vetëm që nuk e dinë se sa do të paguhet, por ka pasur edhe raste kur pagesa nuk është kryer. Ndërkohë nga ana tjetër mësuesit pjesëmarrës në fokus-grupe janë shprehur se pagesa që marrin vlerësuesit e provimeve është mjaftueshmërisht e kënaqshme për punën që ata bëjnë.

Për sa i përket evidentimit të kopjimit, Rregullorja e Maturës Shtetërore parashikon ngritjen e komisioneve KOPOTED (Komision i Possaçëm për Testet e Dyshuara), të cilat siç duket verifikojnë rastet e kopjimit në provimet e MSH-së, por duhet theksuar se komisione të tilla veprojnë në mungesë të plotë transparence. Aktualisht mbetet e paqartë se si testi dërgohet deri në KOPOTED dhe mbi ç'baza ky komision verifikon kopjimin. Siç mbeten të pazbardhura edhe vendimet e këtij komisioni në rastet kur vërtetohet kopjimi apo shkelje të procedurave të parashikuara në Rregulloren e MSH-së prej maturantëve apo subjekteve përgjegjëse për administrimin e provimit.

Ndërkohë vlerësuesit e provimeve të intervistuar gjatë këtij studimi pohojnë se megjithëse ata kanë arritur të dyshojnë për kopjim në shumë raste, për zgjedhja se cilat prej testeve duhet t'i dërgohen KOPOTED-it mbetet në vullnetin e tyre, pasi duket se nuk ka një procedurë apo tregues të përcaktuar për të identifikuar rastet e kopjimit. Sipas vlerësuesve të provimeve, KOPOTED gjatë veprimtarisë së vet zbardh pozicionimin e të gjithë maturantëve në klasën ku ka qenë maturanti, për të cilin dyshohet se ka kopjuar. Më pas rindërtohet skema e uljes nëpër vendet e përcaktuara dhe krahasohen përgjigjet për të parë nëse korrespondojnë. Nisur nga ky informacion, mund të mendojmë se KOPOTED-i ka informacion për shkollën,

klasën dhe bankën ku është ulur secili maturant. Një informacion i tillë mund të ndihmojë në identifikimin e maturantëve testet e të cilëve po merren në shqyrtim. Për këtë arsye janë ngritur dyshime për veprimtarinë e KOPOTED-it, duke hamendësuar se provime të caktuara merren në administrim nga ky komision dhe më pas u rriten artificialisht pikët.

Maturantët pjesmarrës në fokus-grupe, por edhe mësuesit e intervistuar shprehen se skema e llogaritjes së pikëve të Maturës Shtetërore është tejet e ndërlikuar. Ndërkohë, siç është theksuar edhe më lart, pjesa dërrmuese e tyre shprehen se duhet të rritet pesha që mesatarja e katër viteve luan në llogaritjen e pikëve të Maturës Shtetërore.

Për sa i përket vlerësimit final të provimeve, maturantët ankohen se nuk ka transparencë në pasqyrimin e rezultateve, duke mos u dhënë mundësi atyre të kuptojnë se ku kanë gabuar dhe sa pikë kanë marrë në secilin prej ushtrimeve⁶.


Ndërkohë duke qenë se në të gjitha qytetet ku është shtrirë ky studim, ka rezultuar se të gjithë besojnë se kopjohet në provimet e MSH-së, një pjesë e madhe e maturantëve nuk besojnë te rezultatet e saj. Për këtë arsye pjesa dërrmuese e nxënësve, mësuesve dhe administratorëve të provimeve janë shprehur se notat e maturës shtetërore nuk pasqyrojnë pëgatitjen e nxënësit, për pasojë ata nuk besojnë se MSH-ja është një sistem i drejtë vlerësimi që i jep secilit atë që meriton⁷.

Ankimi ndaj vlerësimit

Çështja e ankimit është ngritur thuajse në çdo takim dhe çdo intervistë. Duket se ka një politikë të përgjithshme të institucioneve të përfshira në procesin e Maturës Shtetërore për të mos dhënë asnjë lloj informimi apo orientimi mbi hapat që mund të ndjekë maturanti për t'u ankuar mbi rezultatin e provimit të tij. Kjo vërehet më së miri nga rezultatet e sondazhit, gjatë të cilave vërehet se çështja për të cilën maturantët janë më pak të informuar është “procedurat ankimore për rezultatet e provimit”.

⁶ Maturant në Fier “...edhe sot e kësaj dite nuk e di nëse kam humbur pikë tek eseja në anglisht. Ata nuk të jepnin asnjë lloj shpjegimi...”

⁷ Maturantë në Kukës “...ata kanë marrë nga 4500 pikë, po me pas punu vetë as me kalu klasën s’kishin”



Në të gjithë kuadrin rregullues të Maturës Shtetërore nuk parashikohet asgjë në lidhje me procedurat e ankimit ndaj vlerësimit të provimeve. E vetmja gjë që parashikohet së fundi është e drejta e maturantit për të marrë një fotokopje të provimit të tij, duke iu drejtuar me shkresë KSHMSH-së. Problemi në këtë rast qëndron se përtej burokracisë që përmban ky proces, tarifës së pajustifikuar dhe mungesës së informacionit që i jepet maturantit në lidhje me këtë procedurë; qëndron fakti se edhe nëse evidentohen gabime në vlerësim, rezultatet e provimit nuk ndryshohen. Në kushte të tilla maturanti është i dekurajuar për të kërkuar fotokopjen e provimit të tij, apo të ankohet për vlerësimin që i është bërë. Duhet theksuar se një praktikë e tillë mund të ketë në thelb qëllimin për të mbyllur një shteg korruptiv, ku persona me pushtet mund të kërkojnë rivlerësimin e provimeve të fëmijëve të tyre, duke dëmtuar të gjithë procesin. Gjithashtu, një arsye tjetër mund të jetë edhe kostoja e madhe që mund të ketë administrimi i një numri shumë të madh ankesash, si dhe rivlerësimi i tyre. Por ndërkohë që kjo sjellje i atribuohet besimit në pagabueshmërinë e skemës së korrigjimit të dyfishtë, nxënësit pjesmarrës në fokus-grupe raportojnë për shumë raste të evidentuara të gabimeve në vlerësim, për të cilat nuk është marrë asnjë masë⁸.

⁸ Maturant në Korçë “...arrita të merrja tezën dhe tek qarkimet kisha vetëm një gabim, ndërkohë që pyetjet e hapura I kishin quajtur të gjitha zero. Përgjegjësja për korrigjimin e provimeve më tha që vlerësuesit do hiqen nga puna, por notës tënde nuk kemi çfarë t’i bëjmë tani...”

Me gjithë arsytet që i kanë shtyrë funksionarët e MASH-it për të mohuar të drejtën për ankim, një sjellje e tillë është në kundërshtim jo vetëm me kuadrin ligjor, por edhe me parimet themelore të administratës publike. Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për t'u ankuar ndaj veprimeve të gabuara të Administratës Publike, si dhe askujt nuk mund t'i mohohet mundësia për rivendosjen në vend të një të drejte të mohuar, siç mund të jetë e drejta për arsim. Rastet e maturantëve që kanë fituar të drejtën për një rivlerësim të provimeve përmes vendimit të gjykatës, shprehin më së miri funksionimin e kësaj procedure në shkelje të ligjit.

Vlerësim i përgjithshëm për MSH

Nisur nga fakti që MSH është konceptuar si një vlerësim i standardizuar i arritjeve të nxënësve në shkollën e mesme, shtrohet pyetja: A është MSH një sistem i drejtë vlerësimi?


Gjatë këtij studimi është vjelur mendimi i maturantëve dhe mësuesve lidhur me këtë çështje përmes metodave cilësore dhe sasiore. Kështu, gjatë sondazhit online maturantët kanë vlerësuar MSH-në si më poshtë: në një shkallë 4 deri në 10, ku 4 është baraz me “nuk bie aspak dakord”. Maturantët e anketuar kanë vlerësuar me notën 4.6 pohimin se “*Në perceptimin tim, procesi i zhvillimit të provimeve të MSH ka qenë jo abuziv dhe larg praktikave korruptive*” dhe 4.9 pohimin tjetër “*Në përvojën time, vlerësimi/notat e marra në provimet e MSH kanë qenë të drejta dhe objektive*” (Figura Nr.8).

Pohime të tilla na bëjnë të kuptojmë se në një shkallë të gjerë maturantët “e ngelin në klasë” Maturën Shtetërore, duke e konsideruar atë një proces abuziv dhe të korruptuar, vlerësimet e të cilit janë të padrejta dhe jo objektive.

Një qëndrim i tillë është gjetur edhe në fokus-grupet e zhvilluara, si dhe intervistat e thelluara, ku pyetjes së fundit të intervistës “Në këndvështrimin tuaj, a është MSH një sistem i drejtë dhe i ndershëm vlerësimi?”, pjesa dërrmuese e respondentëve iu përgjigj se në gjykimin e tyre, në mënyrën se si po administrohet ky proces, ai nuk është as i drejtë dhe as i ndershëm.

Një perceptim i tillë është shumë i dëmshëm, edhe nëse nuk do të bazohej në eksperiencën të vërtetë, pasi mosbesimi ndaj MSH dekurajon sjelljen e ndershme të maturantëve, por edhe të AP-ve gjatë zhvillimit të provimeve. Gjithashtu, një perceptim i tillë i përhapur gjerësisht shkurajon përgatitjen e maturantëve gjatë viteve të shkollës, pasi krijon tek ata bindjen se përgatitja e tyre nuk do të shpërblehet në kushtet e mungesës së garimit të ndershëm.

Figura 11. Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme në lidhje me përvojën tuaj në provimet e MSh:
(Në një shkallë nga 4 në 10 ku 4 = “Aspak dakort” dhe 10 = “Shumë dakort”)



Duke marrë përsipër riskun që edhe ky studim të ndikojë në këtë perceptim, vlerësojmë se MASH duhet të marrë masa urgjente jo vetëm për të përmirësuar administrimin e provimeve të MSH (e cila rezulton hallka më e dobët e procesit), por edhe të rrisë ndërgjegjësimin e përgjithshëm të maturantëve dhe mësuesve, duke synuar rritjen e besimit të sistemi. Një seri rekomandimesh se si mund të arrihet kjo gjë, gjenden në seksionin “rekomandime” të këtij studimi.

7. REKOMANDIME

Rekomandime mbi parapërgatitjen dhe administrimin

- Është i nevojshëm një program i strukturuar dhe periodik trajnimesh për mësuesit që do të ofrojnë këshillim dhe orientim për maturantët. Ky trajnim duhet të shtrihet në të gjitha fazat e përgatitjes për provimet e MSH-së, përfshirë edhe plotësimin e formularëve, si dhe orientimin rreth preferencave të degëve të studimit.
- Të merren masa për ta bërë të mundshëm prezantimin e universiteteve publike të maturantët, në mënyrë që këshillimi i karrierës të kthehet në një program të qëndrueshëm dhe efektiv. Disa masa të përshtatshme mund të ishin caktimi për çdo universitet publik i një fondi të veçantë për prezantimin e programeve të studimit në shkollat e mesme të zonës më të afërt (në varësi të qytetit ku ndodhet universiteti publik). Gjithashtu, një set me materiale informuese dhe prezantuese (qoftë edhe materiale audiovizuale) mund të prodhohen nga universitetet publike për t'u vënë në dispozicion të maturantëve. Në një marrëdhënie të tillë bashkëpunimi mes shkollave të mesme publike dhe universiteteve publike, një urë lidhëse mund të luante psikologu i shkollës.
- Një qasje e mirë në të ardhmen do të ishin përpjekjet për të motivuar nxënësit dhe për t'i informuar që herët mbi MSH. Ndryshe nga çfarë është dokumentuar nga ky studim, rekomandojmë që Programi i Maturës Shtetërore, mbi të cilin do të përgatiten maturantët, të vihet në dispozicion që në muajin shtator, duke u dhënë atyre kohën e nevojshme për t'u përgatitur. Motivimi i nxënësve në fillimet e arsimit të mesëm, si dhe një informacion i vazhdueshëm mbi vlerën e një procesi të rregullt, mund të ndikojnë pozitivisht në mbarëvajtjen e MSH.
- Emërimi i AP-ve dhe PAP-ve në qytete të largëta nga vendi ku ata banojnë apo punojnë, është shumë i rëndësishëm për të shmangur rastet e konfliktit të interesit, si edhe presionin social mbi administratorët⁹. Gjithashtu, një zgjidhje alternative do të ishte përfshirja e pensionistëve të aftë fizikisht për të përballuar administrimin dhe mbikqyrjen e provimeve. Masa të tilla do të lehtësonin pozitën e administratorëve të provimeve (AP).
- Rekomandojmë që një vëmendje e veçantë t'i kushtohet konceptimit

9 Një zgjidhje tjetër është të paguhen administratorë që nuk janë me profil nga fusha e mësimdhënies, por aplikimi i kësaj metode, veç fondeve më të mëdha, do të kërkonte edhe studime paraprake mbi rezultatet e mundshme.

të mbarëvajtjes së provimeve të MSH, duke mos u mjaftuar vetëm me respektimin e rregullave të sigurisë, por duke u kujdesuar për garantimin e një procesi të rregullt dhe të ndershëm, sipas standardeve të kërkuara. Një fillim i mirë në këtë drejtim do të ishte një bashkëpunim më i ngushtë ndërmejt stafeve të drejtorive arsimore dhe drejtorëve të shkollave. Ky bashkëpunim duhet të sigurojë jo vetëm përzgjedhjen e mësuesve më të përgjegjshëm si administratorë, por edhe, mbi të gjitha, hartimin dhe zyrtarizimin e kriterëve të përzgjedhjes dhe kualifikimet e nevojshme për administratorët e MSH në të ardhmen.

- Duket se këshillimet falas të ofruara nga shkollat nuk kanë tërhequr interesin e nxënësve më të “dobët” kryesisht për shkak të nivelit të ndryshëm që paraqesin nxënësit në grupet që ndjekin orët e këshillimit. Kjo mund të shmanget në të ardhmen duke organizuar klase të rekuperimit për nxënës me vështirësi ose mangësi në dije. Në këtë mënyrë, ulen gjasat që nxënësit e dobët t’i bazojnë pritshmëritë e tyre te shkelja e rregullave të MSH (kopjimi, komunikimi mes maturantëve, përdorimi i celularit etj.).
- Një mënyrë për t’i mbajtur nxënësit të informuar është krijimi i “këndit për maturën shtetërore”, ku afishohen gjithë informacionet e fundit në lidhje me procesin dhe procedurat e përgjithshme të MSH. Kjo praktikë mund të ndiqet nga të gjitha shkollat.
- Në mjediset ku zhvillohet provimi, mund të instalohet përkohësisht një teknologji që e bën të pamundur përdorimin e celularëve. Për shembull, mund të përdoren pajisje të llojit “zhurmues” që ndërhyjnë me valë GSM. Kjo do të eliminonte komunikimet e mundshme nëpërmjet celularit. Përdorimi i kamerave të lidhura me internetin është këshilluar, gjithashtu, për të evituar abuzimet dhe për të pakësuar presionin mbi AP-të dhe PAP-ët.
- Rekomandojmë marrjen e masave për t’i zhvilluar provimet në salla të mëdha, të cilat të monitorohen, gjithashtu, me kamera. Nisur kjo edhe nga fakti se gjatë këtij studimi janë hasur më pak raste të kopjimit në ato situata kur provimi është zhvilluar në palestër sesa në rastet kur është zhvilluar në klase të vogla.
- Në rastin e qyteteve të vogla apo komunave do të ishte me vlerë zhvillimi i provimeve të MSH-së përmes kompjuterit duke shfrytëzuar laboratorët e informatikës. Kjo risi do të mundësonte një kontroll më të mirë të procesit të zhvillimit të provimeve, si dhe do të zvogëlonte barrën administrative të përcjelljes së testeve dhe dokumentave mbështës në rrugë tokësore, sikurse edhe transportimin e maturantëve nga vendbanimi i tyre në qytetin ku zhvillohet provimi.

- Rekomandojmë përzgjedhjen si administratorë provimi (AP) të personave me integritet të lartë moral, të cilët të trajnohen dhe certifikohen për të kryer këtë detyrë. Ndërkohë e mbi të gjitha një pjesëmarrje e tillë duhet të bazohet në vullnetin e lirë për të qenë AP, bazuar në nxitjen financiare dhe jo përmes detyrimit kundër vullnetit të tyre. Administrimi i provimeve nuk duhet të trajtohet kurrësesi si një punë e papaguar.
- Rekomandojmë marrjen e masave për të bërë efektive këshillimet falas të ofruara nga shkolla duke përfshirë reduktimin e ngarkesës mësimore për mësuesit që ofrojnë këto këshillime, si dhe marrjen e masave për t'i realizuar ato në orare të përshtatshme për nxënësit. Gjithashtu, në mënyrë që ky këshillim të jetë më efektiv, rekomandohet zhvillimi i tyre në grupe të vogla dhe sipas nivelit arsimor të nxënësve. Ndërkohë rekomandohet që këshillimi të fillojnë që në muajin shtator, duke ndihmuar kështu në shpërndarjen e ngarkesës përgjatë vitit.
- Rekomandojmë që mesatarja e tri viteve të shkollës së mesme të zërë një përqindje më të lartë në pikët totale (të jetë më shumë se 20%), duke ndikuar kështu në forcimin e rolit të shkollës së mesme, si dhe në vlerësimin e rezultateve shkollore të siguruara në një periudhë më të gjatë nxëniesje dhe testimi.
- Rekomandojmë hartimin e një fondi publik me pyetje/ushtrime për secilin provim. Në hartimin e tij të ftohen për të marrë pjesë ekspertë dhe mësues të kualifikuar.
- Në mënyrë që të zvogëlohet çdo mundësi për daljen e pyetjeve të provimit, si edhe çdo dyshim mbi këtë proces, rekomandojmë që t'i jepet fund praktikës ku disa punonjës izolojnë për disa ditë për hartimin e tezës përfundimtare. Përdorimi i një programi kompjuterik që përzgjedh në mënyrë rastësore pyetjet bazuar në një fond paraprak pyetjesh do të ishte një zgjidhje e përshtatshme dhe praktike. Gjithashtu, rekomandojmë hartimin e disa tezave të ndryshme për të njëjtin provim, duke ulur kështu mundësitë e kopjimit gjatë provimeve.

Rekomandime mbi procesin e vlerësimit

- Rekomandojmë kompjuterizimin e procesit të vlerësimit të provimeve, duke përdorur lexues optik, çka do të shkurtonte kohën e vlerësimit, si dhe do të minimizonte gabimet në hedhjen e pikëve në figurat përmbledhëse. Sigurisht një rekomandim i tillë do të duhej të shoqërohej me një rikonceptim të testit të provimit, duke u dhënë përparësi pyetjeve të mbyllura.
- Rekomandojmë që në Rregulloren e MSH të parashikohen kritere

profesionale në përzgjedhjen e vlerësuesve të testeve, procedura e përzgjedhjes, si edhe organi përgjegjës për përzgjedhjen. Do të ishte me vend që vlerësuesit e provimeve të certifikohen si të tillë dhe përzgjedhja e vlerësuesve të bëhet vetëm mes personave të certifikuar për të realizuar këtë proces.

- Vlerësuesit e provimeve duhen nxitur financiarisht, çka do ta bënte këtë një detyrë të preferuar, si dhe do të rriste përgjegjshmërinë në zbatimin e saj. Ashtu sikundër shpërblimi i lartë, edhe masat ndëshkuese duhet të jenë të tilla duke shtrirë efektet në karrierën e tyre si mësues.
- Rekomandojmë rritjen e transparencës në lidhje me procedurën e llogaritjes dhe pasqyrimin të pikëve për çdo testim. Gjithashtu, në shpalljen e rezultateve përfundimtare të bëhen publike të gjithë komponentët e vlerësimit të ndarë në kolona të veçanta për secilin maturant (duke iu referuar vetëm me kodin e sekretimit), duke rritur kështu transparencën e procesit.
- Rekomandojmë marrjen e masave për administrimin e ankesave shoqëruar kjo me informimin e maturantëve për hapat që duhet të ndjekin për t'u ankuar. Për të zvogëluar numrin e ankesave MASH-i mund të marrë masa për të publikuar testet online (së bashku me tabelën përmbledhëse të pikëve) ose për të siguruar fotokopje të testit dhe tabelës së pikëve, në çdo rast kur kjo kërkohet nga maturanti.
- Megjithë vështirësitë që kjo mund të paraqesë, në çdo rast MASH-i duhet të parashikojë një periudhë gjatë së cilës të gjitha gabimet e konstatuara në vlerësim të reflektohen në tabelën përfundimtare, pasi vetëm kështu mund të garantojë që veprimet e administratës nuk u mohojnë maturantëve të drejtën për një arsim të mëtijshëm.
- Në Rregulloren e MSH duhet të përcaktohen qartë procedura e identifikimit të provimeve ku dyshohet se është kopjuar, si dhe mënyra se si KOPOTED-i (Komision i Possaçëm për Testet e Dyshuara) e administron procesin deri në marrjen e vendimit.

PJESA II

8. STUDIMI MBI POST-MATURËN

Hyrje

Ky studim mori në shqyrtim Maturën Shtetërore në një këndvështrim më të gjerë, duke mos u mjaftuar vetëm në parapërgatitjen dhe administrimin e provimeve, por edhe me produktin e këtij sistemi vlerësimi. Për të këtë arsye u studiua suksesi i maturantëve, të cilët dy vite më parë fituan të drejtën e studimit përmes Maturës Shtetërore, si dhe u volën eksperiencat e tyre në lidhje me shkollën e mesme. Kështu u zhvillua një anketë me një kampion prej 800 studentësh që ndjekin studimet në vitin e dytë në universitetet shtetërore të Tiranës, Durrësit, Vlorës, Korçës, Gjirokastrës, Shkodrës dhe Elbasanit, të përzgjedhur rastësisht me hapin një në tri.

Metodologjia dhe marzhi i gabimit

Anketa u krye ballë për ballë me studentë të viteve të dyta të universiteteve publike. Për këtë anketë u përcaktua një kampionim rastësor i shtresëzuar nëpërmjet disa hapave.

Marzhi i gabimit

Marzhi i gabimit për këtë anketë është $\pm 3,4\%$ me interval konfidence 95%.¹⁰

Figura më poshtë tregon, kampionin e përlogaritur dhe kampionin e realizuar në terren. Me përjashtim të disa devijimeve në Universitetin “Aleksandër Mosiu” në Durrës, kampioni i realizuar në terren pasqyron kampionin e përlogaritur.

Hapi i parë

Popullata për këtë anketë përbëhet nga studentët e viteve të dyta në universitetet publike. Qëllimi i zgjedhjes së këtyre studentëve ishte se nga njëra anë kanë kaluar një vit në universitet dhe nga ana tjetër janë ende në gjendje të mbajnë mend dhe vlerësojnë çështje të Maturës Shtetërore dhe të shkollës së mesme. Një nga qëllimet kryesore të kësaj ankete është të eksplorojë “lidhjet organike” që ekzistojnë midis nivelit të shkollës së mesme dhe atij universitar, si edhe rolin dhe ndikimin e Maturës Shtetërore.

¹⁰ Teknikisht, një tolerancë gabimi $\pm 3.4\%$ nënkupton që, nëse merren në mënyrë të përsëritur kampione të kësaj madhësie ($N=800$), 95% e tyre do të pasqyronin opinionet e popullatës (studentëve të vitit të dytë) me pasaktësi jo më të madhe se $\pm 3.4\%$.

Hapi i dytë

Shtresëzimi sipas fakulteteve në çdo universitet. Pasi u morën të dhëna për çdo fakultet në lidhje me numrin e studentëve në vit të dytë, u krijua shtresëzimi sipas fakulteteve (Shiko në tabelë).

Hapi i tretë

Përcaktimi i kampionit (mostrës). Përzgjedhja e kampionit u përcaktua me metodën PPS¹¹ e shtresëzuar sipas fakulteteve dhe universiteteve. Numri total i intervistave u përcaktua të ishte N=800.

Hapi i katërt


Përzgjedhja e të anketuarit. Nga lista e studentëve u përzgjedh rastësisht ai numër studentësh i përcaktuar nga kampioni për atë fakultet specifik (plus 20% rezervë) dhe këta studentë u intervistuan nga anketuesit nëpër fakultete.

Nr.	Emri i Universitetit	Fakulteti	Nr. Studentesh	Perlogaritur	Realizuar	Diferenca
1	Universiteti i Tiranës	Fakulteti Ekonomik	1145	46	47	1
		Fakulteti i Drejtësisë	519	21	21	0
		Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	829	33	36	3
		Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë	391	15	12	-3
		Fakulteti i Infermierisë	525	21	23	2
		Fakulteti i Mjekësisë	610	24	22	-2
		Fakulteti i Shkencave Sociale	590	23	24	1
		Fakulteti i Shkencave të Natyrës	1423	57	57	0
Total			6032	240	242	
2	Universiteti Politeknik	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave	299	12	12	0
		Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	684	27	27	0
		Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	322	13	12	-1
		Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	387	15	15	0
		Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	490	20	20	0
		Fakulteti i Inxhinierisë matematike & Fizike	161	6	6	0
Total			2343	93	92	

11 Probability Proportional to Size – mundësia e përzgjedhjes proporcionale me madhësinë e shtresës

3	Universiteti Bujqësor i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	680	27	31	4
		Fakulteti i Bio-teknologjisë dhe Ushqimit	149	6	6	0
		Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	590	23	30	7
		Fakulteti i mjekësisë Veterinare	129	5	5	0
		Fakulteti i shkencave Pyjore	172	7	7	0
Total			1720	68	79	
4	Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan	Fakulteti Ekonomik	398	16	16	0
		Fakulteti i Shkencave Humane	605	24	24	0
		Fakulteti i Shkencave të Edukimit	480	19	19	0
		Fakulteti i Shkencave të Natyrës	505	20	20	0
Total			1988	79	79	
5	Universiteti “Fan S.Noli” Korçë	Departamenti i infermierisë	167	7	6	-1
		Fakulteti i Bujqësisë	146	6	7	1
		Fakulteti i Ekonomisë	385	15	15	0
		Fakulteti i Mësuesisë	647	25	25	0
Total			1345	53	53	
6	Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër	Fakulteti i gjuhëve të huaja	193	8	8	0
		Fakulteti i Drejtësisë	128	5	5	0
		Fakulteti Ekonomik	460	18	19	1
		Fakulteti i Shkencave Shoqërore	551	22	21	-1
		Fakulteti i Shkencave të Edukimit	433	17	13	-4
		Fakulteti i Shkencave të Natyrës	570	23	23	0
Total			2335	93	89	
7	Universiteti “Eq'rem Çabej” Gjirokastrër	Fakulteti edukimit dhe i shkencave shoqërore	563	22	22	0
		Fakulteti i Shkencave të Natyrës	226	9	9	0
Total			789	31	31	
8	Universiteti “Ismail Qemali” i Vlorës	Fakulteti i Edukimit	377	15	17	2
		Fakulteti i Ekonomisë	426	17	15	-2
		Fakulteti i Shëndetit Publik	96	4	4	0
		Fakulteti i Shkencave Teknike	938	37	37	0
Total			1837	73	73	
9	Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës	Fakulteti i Biznesit	274	11	1	-10
		Fakulteti i Edukimit	204	8	15	7
		Fakulteti i shkencave politiko-juridike	56	2	4	2
		Fakulteti i studimeve profesionale	1083	43	51	8
		Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	157	6	1	-5
Total			1774	70	72	
Total të gjitha shkollat			20163	800	810	

Figura 1. Mosha e respondentëve



Për sa i përket moshës së respondentëve, siç shihet edhe në Figurën 1: 33% ishin të moshës nën 19 vjeç, 54% ishin të moshës 20 vjeç dhe 14% ishin më shumë se 20 vjeç.

Kapitulli

1

PËRVOJA
NË ARSIMIN
E MESE


SIBORA DHIMA



9. PËRVOJA NË ARSIMIN E MESËM

Cilësia e shkollimit


Të pyetur mbi cilësinë e shkollimit gjatë shkollës së mesme, 27% e studentëve u përgjigjën me “shumë i/e kënaqur” dhe 43% me “i/e kënaqur”. Pra, rreth 70% e të anketuarve deklaruan se përvoja e tyre kishte qenë e kënaqshme ose shumë e kënaqshme. Duke reflektuar mbi këto gjetje, mund të thuhet se, ndërkohë që përvoja në tërësi e viteve të shkollës së mesme vlerësohet në masë si pozitive, ka ende rrugë për t’u bërë derisa të përmbushen plotësisht pritshmëritë e nxënësve. Në fakt, 26.5% e studentëve u deklaruan si “deri diku i/e kënaqur”, çka tregon se ende një pjesë domethënëse e nxënësve (në këtë rast më shumë se çereku) përballet me sfida të mëdha që ndikojnë si në përvojën e përgjithshme të shkollës së mesme, ashtu edhe në perceptimet mbi cilësinë e arsimit të mesëm.



Studentët që shprehen me rezerva për cilësinë e shkollës së mesme janë pothuajse në masë të barabartë meshkuj dhe femra, siç e tregon Figura 2. Pra 26% e të anketuarve meshkuj dhe rreth 27% e të anketuarve femra deklaruan se ishin “deri diku” të kënaqur. Ndërkohë, në rastin e pakënaqësive të hapura, janë në numër më të lartë meshkujt. Përkatesisht, 5% e të anketuarve meshkuj në krahasim me 1% e të anketuarve femra u deklaruan si “i/e pakënaqur” ose “shumë i/e pakënaqur”. Kështu, ka më shumë meshkuj se femra me pakënaqësi të theksuara mbi cilësinë e shkollimit. Për të kuptuar shkaqet e këtyre perceptimeve mbi cilësinë e arsimit të mesëm, studimi shtroi disa pyetje mbi orët e studimit, mësuesit, tekstet dhe lëndët e zhvilluara.

Orët e studimit

Për sa u përket orëve të studimit, më shumë se gjysma e studentëve të anketuar (55.4% e tyre) deklaruan se gjatë shkollës së mesme studionin mesatarisht “2-3 orë në ditë”, siç paraqitet në Figurën 5 më poshtë. Ndërkohë, 18.4% e të anketuarve studionin shumë më pak – “0-1 orë në ditë”. Vetëm 25.4% e studentëve deklaruan se studionin tej normës kohore mesatare, nga të cilët 20.2% studionin “4-5 orë në ditë” dhe vetëm 5.2% “më shumë se 5 orë në ditë”.




Këto rezultate na shpjen në dy përfundime të rëndësishme.

Së pari, rreth 74% e nxënësve deklaruan se studionin maksimalisht 3 orë në ditë. Vetëm 1/3 e të anketuarve deklaruan se shpenzonin më shumë se katër orë në ditë duke studiuar. Duke pasur parasysh kërkesat ndaj çdo nxënësi gjatë shkollës së mesme, kemi një mospërputhje mes ngarkesës dhe orëve të shpenzuara për çdo nxënësi. Ndërkohë që vazhdojnë përpjekjet për të motivuar nxënësit të mësojnë më shumë, mund të jetë po aq e nevojshme të rimendohet lloji apo sasia e ngarkesës mësimore. Kjo duhet të përshtatet me kohën faktike që shpenzojnë mbi libra nxënësit në ditët e sotme.

Së dyti, po të zbërthejmë rezultatet sipas gjinisë siç paraqitet në Figurën 6 më poshtë, vëmë re këtë prirje: janë pothuajse 30% e meshkujve që kanë deklaruar se studiojnë “0-1 orë në ditë” në krahasim me rreth 9% të femrave. Po ashtu, vetëm rreth 13% e meshkujve kanë deklaruar se studiojnë më shumë se katër orë në ditë, në krahasim me 25% të femrave. Në keto dy intervale trajtohen ata nxënës që studiojnë më shumë ose më pak se mesatarja prej “2-3 orë në ditë”. Ndërkohë që


për intervalin 2-3 orë në ditë kemi raport të ngjashëm si nga studentet femra, ashtu edhe nga studentët meshkuj (56% meshkuj dhe 54% femra), vëmë re se gjinitë diferencohen teksa largohen nga kjo mesatare. Pra, ka një numër më të madh meshkujsh se femrash që studiojnë me pak se mesatarja (0-1 orë në ditë) dhe një numër më të madh femrash se meshkujsh që studiojnë më shumë se mesatarja (më shumë se 4 orë në ditë). Pra, në terma të përgjithshëm meshkujt studiojnë përgjithësisht më pak se femrat.



Lëndët e zhvilluara

Për sa u përket lëndëve të zhvilluara gjatë shkollës së mesme, studentëve të anketuar iu kërkuar të vlerësonin disa pohime në një shkallë nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë “aspak dakord” dhe 10 do të thotë “plotësisht dakord”. Përgjigjet e tyre paraqiten më poshtë në Figurën 7. Pohimi “*I kam kuptuar dhe mësuar lëndet e zhvilluara në shkollën e mesme*” shënoi si përgjigje një mesatare të përgjithshme prej 7.44. Pohimi “*Mendoj se lëndët e zhvilluara në shkollën e mesme kanë qenë sfiduese dhe nxitëse nga pikëpamja intelektuale*” shënoi një mesatare më të ulët, 7.06. Ndërkohë, pohimi që pati përgjigjet më pozitive ishte “*Nga lëndët e ndjekura në shkollën e mesme kam mësuar gjëra që mendoj se janë të vlefshme*” i cili shënoi një përgjigje mesatare prej 8.2. Të dhënat tregojnë se edhe në këto tri pohime, studentet femra janë përgjigjur më pozitivisht se studentët meshkuj, edhe pse me një marzh të vogël ndryshimi. Kështu përvoja mbi lëndët e zhvilluara gjatë shkollës së mesme është përgjithësisht pozitive. Megjithatë, ka hapësira të mëdha për përmirësime, sidomos për sa u përket dy pohimeve të para, që lidhen me faktin se sa janë kuptuar lëndët dhe sa sfiduese kanë qenë ato.

Në një shkallë nga 1 në 10, ku 1 do të thotë nuk jeni aspak dakord dhe 10 do të thotë se jeni plotësisht dakord, sa dakord do të thoshit se jeni me pohimet e mëposhtme në lidhje me ekperiencën tuaj në shkollën e mesme?



Vlerësimi i mësuesve

Në lidhje me vlerësimin mësuesve gjatë shkollës së mesme, studentët vlerësuan me po të njëjtën shkallë katër pohime lidhur me cilësinë e mësimdhënies, që paraqiten po në Figurën 7. Pohimi që mori vlerësimin më të lartë ishte *“shpjegimet e mësuesve në lidhje me lëndën kanë qenë të qarta dhe të kuptueshme”* me një përgjigje mesatare prej 7.73. Ndërkohë, pohimi me vlerësimin më të ulët ishte *“mësuesit i inkurajonin nxënësit të bënin pyetje gjatë orëve të mësimi dhe jepnin përgjigje të vlefshme për këto”* me 7.06. Gjithashtu, me 7.09 u vlerësua pohimi *“në përgjithësi mësuesit i bënin lëndët interesante”* dhe me 7.15 pohimi *“në përgjithësi mësuesit inkurajonin pjesëmarrjen aktive të nxënësve gjatë diskutimeve në klasë”*. Të katra vlerësimet e marra së bashku, pra një mesatare e përgjithshme prej rreth 7.3, flasin për pershtypjet e përgjithshme të studentëve dhe pretendimet e tyre. Kështu, niveli i kënaqësisë së studentëve me mësimdhënien gjatë shkollës së mesme është ende i ulët dhe lë vend për përmirësime, sidomos në rolin që duhet të luajë mënyra e mësimdhënies për ta bërë procesin më interesant dhe më përfshirës.

Tekstet shkollore dhe mënyra e vlerësimit

Në lidhje me tekstet shkollore dhe materialet ndihmëse, studentët vlerësuan pohimin *“tekstet shkollore kishin një cilësi të lartë, po ashtu edhe materialet e tjera ndihmëse”* me një mesatare prej 7.17, **çka** përkon, nga sa thamë më sipër, me përvojën dhe pershtypjet e tyre të përgjithshme mbi shkollën e mesme. Po ashtu, sa i përket kënaqësisë në lidhje me mënyrën e vlerësimit, studentët vlerësuan me 7.8 pohimin *“vlerësimi i performancës së nxënësve (notat) ka qenë i drejtë dhe i përshtatshëm”* dhe me 7.85 pohimin *“procesi i vlerësimit i qëndron gjithmonë besnik asaj që është shpjeguar më parë në klasë”*. Këto paraqiten, gjithashtu, në Figurën 7.

Edhe në lidhje me rezultatet e mësipërme mbi mësimdhënien, tekstet dhe procesin e vlerësimit, studentet femra kanë treguar një kënaqësi lehtësisht më të lartë me procesin në krahasim me studentët meshkuj. Megjithatë mesatarja e përgjithshme e të dy gjinive për gjithë këto pohime së bashku nuk e kalon vlerën 7.44. Kjo notë përfaqëson në një farë mënyre vlerësimin e përgjithshëm që studentët u bëjnë viteve të shkollës së mesme dhe tregon se ka ende pakënaqësi dhe shumë vend për përmirësime.

Kapitulli

2

**VLERËSIME
TË MATURËS
SHTETËRORE**

ENDRIT SHABANI



10. VLERËSIME TË MATURËS SHTETËRORE

Në vija të përgjithshme, gjatë këtij studimi vihet re një tendencë e të anketuarave femra për të dhënë vlerësime më pozitive se meshkujt në të gjitha pyetjet e anketës. Gjithashtu, vihet re një tendencë e nxënësve që vijnë nga shkollat rurale për t'u shprehur më pozitivisht për eksperiencën e tyre gjatë shkollës së mesme, krahasuar me nxënësit që vijnë nga shkollat e Tiranës apo qyteteve të tjera të mëdha.

Nisur nga koha që kanë deklaruar se kalonin duke studiuar gjatë viteve të shkollës së mesme, është vënë re një korrelacion ku ata që deklarojnë se studionin më gjatë (mbi 5 orë në ditë) kanë një tendencë për ta vlerësuar më pozitivisht të gjithë procesin e Maturës Shtetërore (MSH), krahasuar me ata që kanë deklaruar se studionin më pak (0-1 orë në ditë). Një gjetje e tillë lë vend për të interpretuar një farë subjektiviteti në përgjigjet e të anketuarve. Por në të njëjtën kohë nuk është vënë re ndonjë korrelacion midis rezultateve të nxënësit (në shkollë ose në provimet e MSH) dhe qëndrimeve të tyre. Kështu ka ndodhur shpesh që ata, të cilët kanë deklaruar rezultate maksimale si në mësimet, ashtu edhe në provimet e MSH, jo rrallëherë e vlerësojnë këtë proces shumë më negativisht se ata që kanë rezultate tepër të ulta.

Nxënësit dhe përgatitja e tyre për maturën shtetërore

Nisur nga deklaratimet e të anketuarve, në përgjithësi vihet re që nxënësit të kenë marrë nota më të ulta gjatë MSH (mesatarja e katër provimeve 7.58) se gjatë viteve të shkollës (mesatarja e shkollë 8.13). Kjo gjetje u kundërvihet qëndrimeve të mësuesve (gjatë focus-grupeve të mbajtura me ta) ku pjesa dërrmuese e tyre kanë deklaruar se, si pasojë e keqadministrimit të provimeve të MSH, notat që marrin maturantët në këto provime janë shumë më të larta, artificialisht. Nisur nga fakti që kjo tendencë zbritëse ruhet edhe në vitin e parë në universitet (mesatarja e provimeve të vitit të parë 6.5), mund të interpretojmë se këto rezultate mund të jenë pasqyrë e një vlerësimi më tolerant gjatë shkollës së mesme. Por nga ana tjetër nuk përjashtohet edhe ndikimi që mund të ketë luajturi shkalla më e lartë e vështirësisë si në provimet e MSH, ashtu dhe në universitet. Ndërkohë që edhe faktorë të tjerë (brenda dhe jashtë sistemit arsimor) mund të kenë ndikuar, gjithashtu.

Po të krahasojmë rezultatet e deklaruara të atyre maturantëve të cilët kanë fituar të drejtën e studimit, shohim se megjithëse maturantët që vijnë nga qytetet kryesore kanë pasur rezultate më të larta (mesatare 8.17) në shkollë të mesme se nxënësit e shkollave rurale (mesatare 7.91), diferenca ka qenë e ngushtë (0.2 nota). Ndërkohë


që kjo diferencë thellohet edhe më tej gjatë provimeve të Maturës Shtetërore, ku studentët e ardhur nga zonat rurale kanë deklaruar një mesatare 7 të notave të marra në provimet e MSH, që është 0.7 më e ulët se e studentëve të Tiranës dhe qyteteve të tjera të mëdha, të cilët kanë deklaruar një mesatare 7.7. Thellimi i diferencës mund të jetë ndikuar nga faktorë të ndryshëm, si diferencat në cilësinë e mësimdhënies apo diferencat në tolerancën e vlerësimit mes shkollave rurale dhe shkollave të Tiranës. Ky interpretim bazohet edhe në qëndrimin e studentëve të Tiranës, të cilët duke iu përgjigjur pyetjeve të këtij sondazhi duket se janë më të pakënaqur¹² me vlerësimin e mësuesve në shkollë të mesme se studentët e ardhur nga zonat rurale. Ndërkohë nga ana tjetër kjo diferencë mund të shpjegohet edhe me faktin që nxënësit e zonave rurale shkojnë për t'i zhvilluar provimet në qytete të tjera, ku kanë mundësi më të ulta për “t'u ndihmuar”¹ se nxënësit e atij qyteti. Një pohim i tillë mbështetet edhe në rezultatet e notave në universitet, ku diferenca e notave të deklaruara në vitin e parë është sërish e ngushtë (0.3) midis studentëve që vijnë nga zonat rurale (mesatare 6.3) dhe studentëve të Tiranës (mesatare 6.6).

Për sa i përket përgatitjes që marrin në shkollë për provimet e MSH-së, vetëm gjysma e studentëve të anketuar (50.3 %) pohojnë që përgatitja gjatë viteve të shkollës së mesme i ka ndihmuar për t'u përballur me provimet e MSH-së, e ndjekur kjo nga 48.3 %, të cilët shprehen se i ka ndihmuar disi ose pak. Në këtë vlerësim duket se studentëve që kanë ndjekur shkollën e mesme në zonat rurale u ka shërbyer më shumë përgatitja e marrë në shkollë, se nxënësve të Tiranës dhe qyteteve kryesore. Kështu 57 % e nxënësve të shkollave rurale janë shprehur se përgatitja e marrë në shkollën e mesme u ka ardhur “shumë” në ndihmë, krahasuar me nxënësit e Tiranës dhe qyteteve kryesore ku kjo përqindje ka qenë më e ulët (49.4 %). Kjo mund të ketë ndodhur edhe për shkak se nxënësit e shkollave rurale nuk kanë pasur mundësi tjetër për t'u përgatitur përveç shkollës, gjë e cila konfirmohet edhe nga shifrat e përmbysura, ku vetëm 36% e studentëve të ardhur nga shkollat rurale deklarojnë se kanë ndjekur kurse shtesë, ndërkohë që numri i studentëve të ardhur nga Tirana dhe qytetet kryesore, që deklarojnë se kanë marrë konsulta shtesë, është thuajse dyfishi i tyre (59.1%).

Ndërkohë nisur edhe nga rezultatet e shpalosura më sipër, duket se përgatitja e ofruar gjatë orëve të mësimin nuk u ka mjaftuar ish-maturantëve, pasi më shumë se

¹² Studentët që kanë ndjekur shkollën e mesme në Tiranë, kur janë pyetur sa dakord bien me pohimin “vlerësimi i marrë në shkollë të mesme ishte objektiv dhe i drejtë”, kanë deklaruar se janë 7.1 dakord, në një shkallë nga 1 në 10, ku 10 do të thotë të jesh plotësisht dakord. Ndërkohë që studentët e ardhur nga zonat rurale kanë deklaruar 7.5

A E KENI NDJEKUR KURSE SHITESË
(Kurse jashtëshkollore) për t'u përgatitur
për provimet e Maturës Shtetërore?



JO
19.2%

PO
80.8%

**A JU ËSHTË DASHUR TË
PAGUANI PËR KURSET JASHTË-
SHKOLLORE TË NDJEKURA?**


Në shkollën tuaj të mesme a janë
zhvilluar seminare informuese mbi
universitetet, degët/fakultetet apo
aspekte të tjera të arsimit të lartë?

42%
Janë kryer nga
profesorë të
universiteteve
private

14%
Janë kryer nga
profesorë të
universiteteve
publike

25%
Janë kryer
nga stafi
pedagogjik i
gjimnazit

18 %
tjetër



gjysma (55.3 %) e të anketuarve shprehen se për t'u përgatitur për provimet e MSH atyre u është dashur të ndjekin konsulta shtesë. Por, siç vërtetohet edhe nga të dhënat e grumbulluara përmes metodave cilësore të përdorura për këtë studim, maturantëve nuk u kanë ardhur në ndihmë këshillimet falas të ofruara nga shkolla. Kështu vetëm 19.2% e të anketuarve, që kanë pohuar se kanë ndjekur këshillime shtesë, shprehen se i kanë ndjekur falas, përkundrajt 80.8%, të cilët janë shprehur se kanë paguar për to.

Orientimi për shkollën e lartë dhe këshillimi i karrierës

Për sa i përket këshillimit mbi degën e studimit në shkollën e lartë, pjesa më e madhe e studentëve të anketuar (61.3%), shprehen se gjatë viteve të gjimnazit atyre u është ofruar këshillim nga stafi i shkollës (mësuesit, drejtuesit e shkollës etj.), përkundrajt 36.6% që mohojnë t'u jetë ofruar një këshillim i tillë. Në këtë aspekt situata paraqitet e ngjashme si në zonat rurale, ku 62.8% e të anketuarve pohojnë të jenë ndihmuar, ashtu edhe në qytetet kryesore, ku mesatarisht 62.4% kanë pohuar një gjë të tillë.

Përtej këshillimit të vazhdueshëm që ofrojnë mësuesit e shkollës, prej disa vitesh MASH-i ka ndërmarrë një program "orientimi për karrierën", i cili synon bashkëpunimin e shkollës me universitetet për të këshilluar maturantët në lidhje me degët e studimit, perspektivën e punësimit etj. Siç duket, ky program nuk ka funksionuar njësoj në të gjitha shkollat duke bërë që sa më larg qendrës të jetë një shkollë, aq më i lartë të jetë numri i studentëve që deklarojnë mosrealizimin e seminareve informuese për shkollën e lartë. Kështu, nëse 44.2% e studentëve nga zonat rurale deklarojnë se gjatë viteve të gjimnazit në shkollën e tyre nuk është organizuar asnjë seminar i tillë, vetëm thujasë gjysma e tyre (23.8%), studentë nga Tirana, deklarojnë një gjë të tillë. Me gjithë vështirësitë që mund të ketë aksesimi i shkollave në zonat rurale, këshillimi për karrierën është njësoj i rëndësishëm për të gjithë maturantët, pasi një zgjedhje e bërë në mungesë të këshillimit mund të prodhojë një karrierë të çuar dëm. Ndërkohë sa i përket entit që ka organizuar seminarin informues, duket se bashkëpunimi me universitetet shtetërore nuk ka funksionuar sa ç'pritej. Për pasojë vetëm 14 % e studentëve të anketuar pohojnë se këto seminare janë zhvilluar nga pedagogë të universiteteve shtetërore, krahasuar me 41.9% që deklarojnë se ato janë zhvilluar nga universitetet private. Problemi që lind nga kjo indiferencë e universiteteve shtetërore është se shpesh universitetet private, që zhvillojnë këto seminare me maturantë, më shumë i përdorin ato për të bërë reklamë mbi përparësitë e universitetit të tyre sesa japin informacion mbi degët e studimit. Një gjë e tillë vihet re edhe nga përgjigjet që kanë dhënë studentët që deklaruan se kanë ndjekur seminarin e zhvilluar prej universiteteve private, ku 57.7 % e tyre u përgjigjen se u diskutua për *përparësitë e universitetit* që zhvilloi seminarin, 15.3% u shprehën se u diskutua për *natyrën e degës së studimit* dhe 25.6% e tyre u shprehën se u diskutua për *perspektivën e degës së studimit* në tregun e punës.

Provimet e Maturës

Të pyetur mbi shkallën e vështirësisë së provimeve të MSH, 38% e studentëve të anketuar shprehen se këto provime kanë qenë *të vështira* ose *shumë të vështira*. Ndërkohë që 57.8% e tyre shprehen se kanë qenë deri diku të vështira. E parë në rrafshin gjeografik, duket se studentët nga Tirana i kanë ndier më të vështira provimet e MSH sesa nxënësit që kanë studiuar në zonat ruale. Kështu, 41.1 % e studentëve nga Tirana i konsiderojnë provimet e MSH të vështira ose shumë të vështira, krahasuar me 38.4 % të studentëve që kanë ndjekur shkollën e mesme në zonat rurale. Një nga faktorët që mund të ketë ndikuar në rritjen e shkallës së vështirësisë për maturanët e Tiranës, mund të ketë qenë edhe rigoroziteti më i madh i administrimit të provimeve të MSH, ndryshe nga shkolla të cilat kanë qenë më larg vëmendjes (e për pasojë edhe monitorimit) të institucioneve dhe medias.

	Gjatë shkollës së mesme, mesatarisht sa orë në ditë keni studiuar pas mësimit ?			
	0-1 orë në ditë	2-3 orë në ditë	4-5 orë në ditë	Më shumë se 5 orë në ditë
	Mesatare	Mesatare	Mesatare	Mesatare
1. Përbajtja e provimeve të Maturës Shtetërore pasqyron më së miri njohuritë e përfituara gjatë shkollës së mesme	7.37	7.86	7.80	8.63
2. Përbajtja e provimeve të maturës përputhet me programin orientues të Maturës Shtetërore	7.54	7.69	7.69	8.10
3. Përbajtja e provimeve të maturës përputhet me orientimet e ofruara në klasë nga mësuesit	7.29	7.64	7.59	8.88
4. Në perceptimin tim, procesi i zhvillimit të provimeve të Maturës Shtetërore ka qenë jo-abuziv dhe larg praktikave	6.12	6.26	6.21	6.31
5. Në përvojën time vlerësimi/notat që kam marrë në provimet e Maturës Shtetërore kanë qenë të drejta dhe objektive	6.88	7.32	7.42	8.36
6. Në përvojën time, maturanët kanë kopjuar gjatë zhvillimit të provimeve të maturës shtetërore	6.92	7.00	6.76	6.93
7. Në perceptimin tim, maturanët fituan ato dege që meritonin	5.77	5.79	6.10	6.12
Total	148	445	162	42

Ndërkohë, nëse do të ndërtojmë një kurbë midis notës mesatare të shkollës së mesme dhe qëndrimeve mbi vështirësinë e provimeve, do të shohim se (me ndonjë përjashtim) kurba tregon një tendencë të tillë: sa më e lartë mesatarja e respondentit, aq më të thjeshta i ka konsideruar ai provimet e MSH. Kështu mund të themi se kryesisht provimet nuk kanë qenë të vështira për nxënësit me rezultate të mira në mësim. Gjithashtu, duket se rol të rëndësishëm ka pasur edhe vetë përgatitja e maturanëve, pasi studentët që kanë deklaruar se gjatë viteve të gjimnazit studionin

0-1 orë në ditë, kanë pasur një prirje për t'i konsideruar provimet e MSH si *të vështira*. Kështu 52.7% e studentëve që kanë deklaruar se gjatë shkollës së mesme studionin 0-1 orë në ditë, i kanë konsideruar provimet e MSH *të vështira* ose *shumë të vështira*. Ndërkohë që një vlerësim të tillë për provimet e MSH e kanë mbajtur vetëm 26.2% e studentëve që kanë deklaruar se studionin më shumë se 5 orë në ditë.

Vështirësia e provimeve të MSH ndikon drejtpërdrejt në rezultatet që arrijnë maturantët dhe për pasojë në të drejtën e tyre të studimit. Kështu rezulton se ata që i kanë konsideruar provimet e MSH si të vështira ose shumë të vështira, kanë marrë nota 7 e poshtë në këto provime.

Për sa u përket qëndrimeve të studentëve në lidhje me MSH, atyre u janë dhënë disa pohime dhe u është kërkuar që të shprehin dakordësinë e tyre në një shkallë 1 deri në 10, ku 10 do të thotë se janë *plotësisht dakord*.

<i>Në një shkallë nga 1 në 10, ku 1 do të thotë se nuk jeni aspak dakord dhe 10 do të thotë se jeni shumë dakord, sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme në lidhje me përvojën tuaj në provimet e Maturës Shtetërore?</i>	<i>Vlerësimi</i>
MA9.1 Përmbajtja e provimeve të Maturës Shtetërore pasqyron më së miri njohuritë e përfituara gjatë shkollës së mesme	8
MA9.2 Përmbajtja e provimeve të maturës përputhej me programin orientues të Maturës Shtetërore	8
MA9.3 Përmbajtja e provimeve të maturës përputhej me orientimet e ofruara në klasë nga mësuesit	8
MA9.4 Në perceptimin tim, procesi i zhvillimit të provimeve të Maturës Shtetërore ka qenë jo-abuziv dhe larg praktikave	6
MA9.5 Në përvojën time vlerësimi/notat që kam marrë në provimet e Maturës Shtetërore kanë qenë të drejta dhe objektive	7
MA9.6 Në përvojën time, maturantët kanë kopjuar gjatë zhvillimit të provimeve të maturës shtetërore	7
MA9.7 Në perceptimin tim, maturantët fituan ato degë që meritonin	6

Nga rezultatet e përgjithshme vëmë re se studentët bien më pak dakord me pohimet “*maturantët fituan në ato degë studimi që meritonin*” ku kanë dhënë një notë 5.87; dhe “*procesi i zhvillimit të provimeve të MSH ka qenë jo-abuziv dhe larg praktikave korruptive*” me një notë 6.22. Një korrelacion mes këtyre dy qëndrimeve na bën të kuptojmë se studentët janë të qëndrimit që provimet e MSH nuk janë administruar siç duhet duke lejuar abuzimin, çka sjellë për pasojë që maturantët të mos marrin atë që meritojnë. Qëndrime të tilla janë në sinkron edhe me rezultatet e fokus-grupeve të zhvilluara, gjatë të cilave ish- maturantë dhe mësues folën për një shkallë të lartë abuzimi gjatë provimeve të MSH. Abuzime të tilla dëmtojnë thelbin e MSH, i cili është t'u krijojë mundësi nxënësve të konkurrojnë në mënyrë të ndershme me

njëri-tjetrin dhe të zgjedhin degën e studimit në universitetet shtetërore përmes kriterit meritë-preferencë.

Më pas studentët janë pyetur mbi aspekte të tjera të provimeve të MSH. Kështu në lidhje me përmbajtjen e provimeve të MSH, studentët shprehën se bien deri diku dakord (7.67) me pohimin që *ato përputheshin me programin orientues*. Megjithatë studentët bien dakord në një shkallë relativisht të lartë me këtë pohim, ky rezultat tregon se ata kanë rezerva në këtë pikë. Përmbajtja e provimeve të MSH është një problem delikat, pasi ato duhet domosdoshmërisht të jenë 100 % të përputhura me programin orientues, me të cilin maturantët përgatiten. Çdo pyetje jashtë programit orientues përveçse dëmton konkurrimin e ndershëm, bën që në nivel afatgjatë të ulët besimi i maturantëve (në vitet pasardhëse) te programi orientues, duke u shkaktuar atyre konfuzion dhe pasiguri në përgatitjen për provimet e MSH.

Gjithashtu, studentët janë shprehur se ata bien dakord në një shkallë 7.63 me pohimin se *përmbajtja e provimeve të maturës shtetërore përputhej me orientimet e ofruara në klasë nga mësuesit dhe në një shkallë 7.8 me pohimin tjetër se përmbajtja e provimeve pasqyron më së miri njohuritë e përfutuara gjatë shkollës së mesme*. Edhe për këto pohime studentët, që kanë deklaruar se studionin mbi 5 orë në ditë, kanë qenë më tepër dakord (8.63 për pohimin e parë dhe 8.88 për pohimin e dytë) se ata që studionin 0-1 orë në ditë (7.37 për pohimin e parë dhe 7.29 për pohimin e dytë).

Për sa i përket miradministrimit të provimeve të MSH, kjo është një çështje delikate, e cila është pa dyshim e bazuar mbi perceptimin personal të të anketuarve, por jo rrallë ky perceptim është ngritur mbi eksperiencën personale. Duke qenë se gjatë pjesës së parë të studimit, ku u përdorën metodat sasiore të kërkimit shkencor, u evidentuan probleme të mëdha me administrimin e provimeve të MSH, u është kërkuar studentëve të shprehin dakordësinë e tyre në lidhje me disa pohime, njësoj si më lart. Kështu, thuajse të gjithë maturantët, pavarësisht gjinisë apo pozicionit gjeografik nga kanë studiuar, kanë rënë dakord (6.92) me pohimin se *bazuar në përvojën e tyre, maturantët kanë kopjuar gjatë zhvillimit të provimeve të MSH*. Një dakordësi në një shkallë të tillë është shumë shqetësuese, aq më tepër kur pohime të tilla pranohen në një shkallë të lartë edhe nga studentët që kanë deklaruar rezultate të larta si në shkollën e mesme, ashtu edhe në provimet e MSH.

Gjatë një interviste me një administrator provimi (AP) ai u shpreh se ka një tendencë të AP-ve, të cilët janë mësues të të njëjtut qytet ku zhvillohet provimi, që të tolerojnë kopjimin e nxënësve të qytetit të tyre, por ndërkohë të jenë strikt me nxënësit që vijnë nga zonat rurale.

Kapitulli

3

**FAKTORËT
QË NDIKOJNË
NË ZGJEDHJEN
E DEGËS
SË STUDIMIT**

AURON PASHA



11. FAKTORËT QË NDIKOJNË NË ZGJEDHJEN E DEGËS SË STUDIMIT

Mesatarja e notave

Studentët e anketuar të vitete të dyta të universiteteve publike u pyetën në lidhje me vlerësimet (notat) e marra gjatë viteve të shkollës së mesme, në Maturën Shtetërore dhe gjatë vitit të parë të universitetit. Qëllimi ishte për të parë lëvizjet në performancë nga njëri nivel shkollor në tjetrin. Nga rezultatet e anketës del se studentët e universiteteve publike kanë pasur një performancë relativisht të lartë në shkollën e mesme. Nota mesatare e deklaruar për shkollën e mesme nga të anketuarit është 8.1, një shifër e kënaqshme. Performanca e tyre bie pak në provimet e Maturës Shtetërore, ku mesatarja e deklaruar për të gjitha provimet e maturës rezulton të jetë 7.6 sipas deklarimeve.

	Të gjithë studentet	Meshkuj	Femra
Afërsisht, sa ka qenë nota juaj mesatare e përgjithshme në shkollën e mesme, pa përfshirë notat e provimeve të maturës?	8.13	7.8	8.38


Kur krahasohen këto rezultate të shkollës së mesme me performancën e vitit të parë në universitet, rezulton se ka ndryshime të dukshme. Sipas deklarimeve të të anketuarve rezulton se mesatarja e provimeve të vitit të parë në universitet është 6.5, rreth 1 notë më e ulët se mesatarja e provimeve të Maturës dhe me përafërsi 2 nota më poshtë se mesatarja e gjithë shkollës së mesme. Nga këto vetëdeklarime¹³ të studentëve duket qartë se performanca e tyre e vlerësuar me notë, vjen duke rënë nga shkolla e mesme në universitet. Faktorët që mund të shpjegojnë këtë trend përgjithësisht të pranuar, mund të jenë të shumtë.

Motivimi

Disa faktorë mund të lidhen me motivimin e studentëve, të cilët në shkollë të mesme kanë presion të madh për të pasur rezultate të larta, me qëllim që të sigurojnë hyrjen në universitet. Me të arritur këtë objektiv (pranimin në universitet), motivimi/presioni për të pasur rezultate të larta mund të bjerë.

¹³ Përgjithësisht “vetëdeklarimi i notave” tenton të jetë më “i zbutur” se realiteti, pra notat e vetëdeklaruar janë pak më të larta se ç’janë në realitet. Por ajo që ka rëndësi në këtë analizë është ndryshimi nga njëri nivel në tjetrin (Shkollë e Mesme – Universitet) pavarësisht faktit se janë vetëdeklarime.

Figura 5. Sa i motivuar ndiheni për të studjuar në degën/fakultetin ku studioni aktualisht?



Të anketuarit u pyetën për një vlerësim të përgjithshëm të motivimit që ata kanë për të studiuar në degën/fakultetin që po ndjekin aktualisht.

Vetëm rreth 24% e tyre deklarojnë se ndihen “**shumë të motivuar**”, ndërsa rreth 41% deklarojnë se ndihen “**të motivuar**”. Më shumë se 35% e të anketuarve, pra më shumë se 1 në 3 studentë, deklarojnë se nuk ndihen “të motivuar”¹⁴ të studiojnë në degën aktuale. Ky është një deformim i përgjithshëm i sistemit universitar që në njëfarë mënyre “prodhon” të diplomuar me performancë të ulët dhe të pamotivuar për të ardhmen profesionale.

“Motivimi” i studentëve për të studiuar në degën që ndjekin aktualisht, i analizuar në lidhje me renditjen e bërë nga studenti për këtë degë, në formularin e përzgjedhjes së shkollës së lartë, tregon se ka një korrelacion të lartë midis shkallës së motivimit dhe preferencës së degës/fakultetit. Sa më larg të jetë “dega” nga preferencë e parë e studentit aq më shumë rritet “demotivimi” për të studiuar.

¹⁴ Sipas shkallës ndihen “Deri diku të motivuar/pamotivuar”, “Pak të motivuar” ose “Aspak të motivuar”. Kategoria e parë “Deri diku të motivuar/Pamotivuar” në fakt është një vlerësim mesatar, por duke menduar për Motivimin si një shkallë vlerësimi, është më shumë një “kompromis” sesa motivim pozitiv për të anketuarin.

Gjatë procesit të aplikimit për në universitet, si e keni renditur degën ku po studioni aktualisht?	Sa i motivuar ndiheni për të studiuar në degën/fakultetin ku studioni aktualisht?				
	Shumë i/e motivuar	I/e motivuar	Deri diku i motivuar/pamotivuar	Pak i/e motivuar	Aspak i/e motivuar
Të parën	35.7%	37.5%	20.5%	2.5%	3.5%
Të dytën	19.7%	53.0%	21.3%	3.8%	2.2%
Të tretën	21.3%	39.0%	31.6%	4.4%	3.7%
Të katërtën	9.0%	38.5%	41.0%	9.0%	2.6%
Më poshtë se e katërta	13.9%	32.4%	34.3%	11.1%	8.3%
Nuk e kam zgjedhur në formularin A3/A4	14.3%	38.1%	28.6%	14.3%	4.8%

Performanca e studentëve sipas preferencës së degës/fakultetit

Një nga faktorët që mund të ndikojë drejtëpërsëdrejti në performancën e studentëve në universitet është dëshira që ata kanë për të ndjekur degën e projektuar sipas renditjes/preferencës së shënuar në formularin e përzgjedhjes së shkollës së lartë. Sa më lartë të jetë në renditje kjo degë, aq më shumë dëshirë (përkthe “motivim”) ka studenti për të mësuar dhe për të marrë rezultate më të larta.

Gjatë procesit të aplikimit për në universitet, si e keni renditur degën ku po studioni aktualisht në listën e preferencës? * Mesatarja e notave të vitit të parë të Universitetit	Mesatare
Të parën	7.01
Të dytën	6.49
Të tretën	6.20
Të katërtën ose më poshtë	6.00
Total	6.50


Kjo hipotezë vërtetohet plotësisht nga të dhënat e anketës. Vlerësimi mesatar për provimet e vitit të parë për studentët, të cilët studiojnë në degën që e kanë renditur të parën (preferencë e parë) në përzgjedhje, është 7. Ky vlerësim vjen duke u ulur me uljen e preferencës dhe për ata që aktualisht po ndjekin një degë që e kanë renditur të katërtën ose më poshtë në formular, nota mesatare shkon në 6.

Është për t'u theksuar se vetëm 35% e të anketuarve pohojnë se dega që po ndjekin aktualisht ka qënë preferencë e tyre e parë. Pra, përafërsisht 2 në 3 studentë të universitetit nuk po ndjekin degën që ka qënë preferenca e tyre e parë.

Disa faktorë të tjerë mund të kenë të bëjnë me i) mënyrën e vlerësimit të studentëve, që ndryshon nga shkolla e mesme në universitet, ii) ngarkesën mësimore apo iii) larminë e subjekteve/lëndëve që duhen mësuar etj.

Përkundër gjithë këtyre faktorëve, që mund të ndikojnë në ndryshimin e performancës, rezultatet e anketës konfirmojnë se:

Performanca e nxënësve në shkollë të mesme (si mesatare e gjithë viteve të shkollës së mesme apo aq më shumë si mesatare e provimeve të Maturës Shtetërore) nuk ruhet në shkollë të lartë, por vjen duke u përkeqësuar.



Orët e studimit


Është interesante të vihet re se koha që harxhojnë studentët e universitetit për të studiuar, nuk ndryshon nga ajo që ata deklarojnë se ishte koha e harxhuar për studim gjatë viteve të shkollës së mesme (18.6% deklarojnë se harxhojnë 0-1 orë në ditë për studim gjatë vitit universitar krahasuar me 18,4% që deklarojnë të njëjtën gjë për shkollën e mesme. Po kështu, 55,6% deklarojnë se harxhojnë 2-3 orë në ditë studim në universitet, krahasuar me 55,4% që deklarojnë të njëjtën gjë për shkollën e mesme). *Pra, investimi në kohë për shkollën nuk ndryshon nga shkolla e mesme në universitet, por performanca e studentit ulet (sipas vlerësimit me notë).*

Studime cilësore të mëparshme të kryera në lidhje me hendekun që ekziston midis performancës në shkollë të mesme dhe asaj në shkollë të lartë sugjerojnë, megjithatë, se ngarkesa e lëndëve në universitet vlerësohet shumë më e madhe se ajo e shkollës së mesme.¹⁵ Në diskutime të ndryshme gjatë grupeve të fokusuara, studentët deklarojnë se pikërisht kjo ngarkesë është faktori kryesor për performancën e tyre të pakënaqshme.

¹⁵ Matura Shtetërore, një vlerësim i sistemit – IDRA 2012. Një studim pilot mbi Maturën dhe studentët e Universitetit të Tiranës.

Krahasimi i cilësisë së shkollimit

Është për t'u theksuar se ka diferenca në kënaqësinë e shfaqur nga të anketuarit për sa i përket cilësisë së shkollimit në shkollë të mesme dhe në të lartën. Më shumë se 70% e të anketuarve shprehen “të kënaqur”¹⁶ me cilësinë e shkollimit në shkollë të mesme, ndërkohë që shifra ulet në rreth 50% kur të anketuarit pyeten në lidhje me cilësinë e shkollimit në universitet. Duke pasur parasysh nivelin e motivimit të analizuar më lart dhe “lidhjen” me degën specifike që ndjekin aktualisht, kjo ulje e “kënaqësisë” ka shpjegim.



Vetë studentët japin disa indikacione në lidhje me shpjegime të mundshme (sipas perceptimit të tyre) për këtë diferencë në performancë. Studentëve iu kërkua të vlerësonin në një shkallë nga 1 në 10, ku 1 do të thoshte “nuk jam aspak dakord” dhe 10 do të thoshte “jam shumë dakord”, pohime të ndryshme lidhur me disa dimensionet e cilësisë së arsimit të mesëm e më pas atij të lartë. Këto dimensionet, të formuluar nga Herbert Marsh¹⁷ përdoren gjerësisht për të vlerësuar cilësinë e arsimit në lidhje me kuptueshmërinë dhe vlefshmërinë e procesit mësimor, entuziazmin e instruktorit gjatë mësimdhënies, organizimin e procesit të mësimi, shtysat për të krijuar një proces mësimor interaktiv, si dhe objektivitetin dhe përshtatshmërinë e mënyrës së vlerësimit.

¹⁶ Kjo kategori përfshin ata që janë përgjigjur “shumë të kënaqur” (27.2%) dhe “i/e kënaqur” (43.3%)

¹⁷ Marsh, H. E. (1982), SEEQ: A Reliable, Valid, and Useful Instrument for Collecting Students' Evaluations of University Teaching. British Journal of Educational Psychology, 52: 77–95.

Në një vështrim të përgjithshëm, pothuajse të gjitha pohimet që kanë të bëjnë me cilësinë e shkollimit kanë marrë notë më të mirë për nivelin e shkollës së mesme sesa atë universitar (viti i parë) sipas shkallës së dakordësisë nga 1 deri në 10 (në tabelën e mëposhtme të gjitha kutizat e ngjyrosura me blu tregojnë pohimet, të cilat kanë marrë vlerësim më të mirë për shkollën e mesme krahasur me universitetin). Pra, të anketuarit **e vlerësojnë më lart cilësinë e shkollimit në shkollën e mesme se në universitet.**

Sipas të anketuarve;

- Ata i **“I kanë kuptuar dhe mësuar lëndët e zhvilluara”** më mirë në shkollë të mesme se në universitet.
- **“Nga lëndët e ndjekura në shkollë të mesme kanë mësuar gjëra të vlefshme”** më shumë se nga lëndët e universitetit
- **“Shpjegimet e mësuesve në shkollë të mesme kanë qenë të qarta dhe të kuptueshme”** më shumë se ato të pedagogëve në universitet
- **“Mësuesit e shkollës së mesme i bëjnë lëndët interesante”** më shumë se pedagogët e universitetit
- **“Mësuesit e shkollës së mesme inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësit”** më shumë nga ç’e bëjnë këtë pedagogët e universitetit.
- **Tekstet e shkollës së mesme vlerësohen si më të mirë se ato të universitetit** sa i përket cilësisë.

Një nga diferencat më të mëdha sipas të anketuarve është ajo që ka të bëjë me vlerësimin e performancës së studentit. Sipas të anketuarve, **vlerësimi i nxënësit në shkollë të mesme ka qenë i drejtë dhe i përshtatshëm**, vlerësuar me notën 7.8 në shkallën nga 1 deri në 10. Ndërsa vlerësimi i studentit për nivelin universitar ka marrë notën 5.9, që tregon se të anketuarit nuk mendojnë se ky vlerësim është aq i drejtë sa ç’ka qenë në shkollë të mesme. Edhe pohimi se **“procesi i vlerësimit i qëndron besnik asaj që është shpjeguar më parë”** ka marrë notë më të lartë për nivelin e shkollës së mesme sesa atë universitar. Studimi i IDRA 2012, gjeti po të njëjtën karakteristikë të shprehur nga studentët në lidhje me këtë mënyrë veprimi. Sipas pedagogëve të intervistuar për këtë studim (IDRA 2012), diferenca kryesore ka të bëjë me paaftësinë e sistemit para-universitar për t’i përgatitur studentët të mësojnë në mënyrë kritike dhe selektive (pra jo mekanike), të analizojnë dhe argumentojnë informacionin apo ta artikulojnë qartë atë. Për këtë arsye, studentët, të përballur me informacion shumë më voluminoz në universitet, nuk janë në gjendje ta filtrojnë atë sipas kërkesave të provimeve apo pedagogëve.

Në një shkallë nga 1 në 10, ku 1 do të thotë nuk jeni aspak dakord dhe 10 do të thotë se jeni shumë dakord, sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme në lidhje me ekperiencën tuaj në shkollë të mesme dhe në universitet (viti i parë).

SHKOLLË E MESME		UNIVERSITET		DIF.
I kam kuptuar dhe mësuar lëndët e zhvilluara në shkollën e mesme	7.44	I kam kuptuar dhe mësuar lëndët e zhvilluara në vitin e parë të shkollës së lartë	6.54	0.9
Mendoj se lëndët e zhvilluara gjatë shkollës së mesme kanë qenë sfiduese dhe nxitëse nga pikëpamja intelektuale	7.06	Mendoj se lëndët e zhvilluara gjatë vitit të parë të shkollës së lartë kanë qenë sfiduese dhe nxitëse nga pikëpamja intelektuale	7.12	-0.1
Nga lëndët e ndjekura në shkollën e mesme kam mësuar gjëra që mendoj se janë të vlefshme	8.20	Nga lëndët e ndjekura në universitet kam mësuar gjëra që mendoj se janë të vlefshme	8.03	0.2
Shpjegimet e mesuesve në lidhje me lëndën kanë qenë të qarta dhe të kuptueshme	7.73	Shpjegimet e pedagogëve në lidhje me lëndët kanë qenë të qarta dhe të kuptueshme	7.19	0.5
Në përgjithësi mësuesit i bënin lëndët interesante	7.09	Në përgjithësi pedagogët i bënin lëndët interesante	6.55	0.5
Në përgjithësi mësuesit inkurajonin pjesëmarrjen aktive të nxënësve gjatë diskutimeve në klasë	7.15	Në përgjithësi pedagogët inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësve gjatë diskutimeve në klasë	6.33	0.8
Mësuesit i inkurajonin nxënësit të bënin pyetje gjatë orëve të mësimit dhe jepnin përgjigje të vlefshme për këto pyetje	7.06	Pedagogët i inkurajonin studentët të bënin pyetje gjatë orëve të mësimit dhe jepnin përgjigje të vlefshme për to	6.49	0.6
Tekstet shkollore kishin një cilësi të lartë, po ashtu edhe materialet e tjera ndihmëse	7.17	Tekstet dhe materialet e tjera ndihmëse kanë qenë të përgatitura mirë	6.84	0.3
Vlerësimi i performancës së nxënësve (notat) ka qenë i drejtë dhe i përshtatshëm	7.80	Vlerësimi i performancës së studentëve (notat) ka qenë i drejtë dhe i përshtatshëm	5.93	1.9
Procesi i vlerësimit i qëndron gjithmonë besnik asaj që është shpjeguar më parë në klasë	7.85	Përmbajtja e provimeve apo vlerësimeve të tjera (projekte etj.) i përshtatej asaj çka ishte shpjeguar më parë në klasë	7.13	0.7

Pavarësisht se këto perceptime mund të ndikohen nga fakti se studentët nuk studiojnë të gjithë në degët që kanë qenë preferencë e tyre e parë, apo në përgjithësi nga një nivel më i ulët motivimi, përsëri është shqetësuese që niveli universitar merr vlerësime të tilla nga studentët.

Kapitulli

4

PËRVOJA ME ARSIMIN E LARTË PUBLIK

DRITAN NELAJ



12. PËRVOJA ME ARSIMIN E LARTË PUBLIK

Cilësia e arsimit të lartë ndikohet nga një mori faktorësh përfshirë dhe cilësinë e studentëve, të cilët përmes bashkëveprimit mes vetit dhe stafit akademik përgjatë procesit të mësimdhënies, ndërtimit dhe transferimit të dijes, si dhe vlerësimit, janë vendimtarë në cilësinë e përgjithshme të produktit të universiteteve. Në literaturën bashkëkohore për arsimin e lartë theksohet vazhdimisht fakti që procesi i mësimdhënies, transferimit, si dhe transformimit të dijes nuk kalon përmes një rruge mekanike nga pedagogu te studenti, por një pjesë e mirë e këtyre proceseve varen dhe ndikohen pashmangshmërisht nga cilësia dhe roli i studentëve. Për pasojë autorë të ndërtimit të procesit të qarkullimit të dijes, si dhe zhvillimit të kompetencave brenda institucioneve të arsimit të lartë janë njëherazi pedagogët dhe studentët. Duke u nisur nga ky arsytim studimi u interesua për performancën, si dhe përvojën në universitet të studentëve të vitit të dytë. Ndër të tjera përmes studimit grupi i kërkuesve ishte i interesuar për të hulumtuar dinamikat dhe impaktin e produktit të Maturës Shtetërore në cilësinë dhe performancën e arsimit të lartë publik në tërësi.

Të dhënat e anketës tregojnë se mesatarja e notave të vitit të parë në shkollën e lartë e raportuar nga vetë studentët është dukshëm më e ulët krahasuar me mesataren e shkollës së mesme apo atë të provimeve të Maturës Shtetërore. Duket se nota mesatare e studentëve për secilin universitet pasqyron cilësinë e perceptuar në publik dhe hapësirën mediatike për universitete të caktuara. Figura tregon se përgjithësisht ato universitete që kanë një prestigj më të lartë thithin maturanët me rezultate më të larta dhe për rrjedhim, megjithë rënien në performancë gjatë vitit të parë në universitet, përsëri mesatarja e tyre krahasuar me atë të studentëve që studiojnë në universitetet e tjera rapotohet të jetë më e lartë.


Shpërndarja demofigure e maturanëve në morinë e universiteteve publike përbën një aspekt interesant. Figura e mëposhtme tregon se universiteti “Aleksandër Xhuvani”, “Luigj Gurakuqi” dhe “Eqerem Çabej” marrin një numër të konsiderueshëm të maturanëve me preardhje nga zonat rurale dhe qytetet e vogla.

Shkalla e motivimit të studentit, e cila ndikohet edhe nga përputhshmëria midis preferencës për degën/universitetin dhe institucionit ku studenti vijon studimet e tij, mund të luajë një rol të rëndësishëm në rezultatet akademike. Figura e mëposhtme tregon se një përqindje e mirë e studentëve (35.1 %) vijojnë studimet e tyre në degë

MESATARJA E PROVIMEVE TË VITIT TË PARË

TOTAL 6.5

SHPËRNDARJA DEMOGRAFIKE E MATURANTËVE NË UNIVERSITETET PUBLIKE




dhe universitete, të cilat kanë qenë pjesë e preferencës së tyre të parë, e ndjekur kjo nga rreth 22.7% e studentëve, të cilët deklarojnë se fakulteti ku studiojnë ka qenë preferenca e tyre e dytë në aplikimin për universitet. Këto përqindje flasin për një shpërndajre relativisht eficiente të studentëve sipas parimit meritë – preferencë. Sidoqoftë nga studimi rezulton se 23% e studentëve janë pranuar në degë studimi, të cilat përbëjnë preferencën e katërt apo edhe më tutje, gjë që mund të ndikojë ndjeshëm shkallën e tyre të motivimit për t'u angazhuar seriozisht në procesin e studimit, si dhe aftësinë e tyre për t'u përballur me kërkesat akademike të degës së studimit.

Gjatë procesit të aplikimit për në universitet, si e patë të renditur degën ku po studioni aktualisht në Formularin A2?	Tirane	Qytetet kryesore	Qytetet urbane të tjera	Zonat rurale
Të parën	35.1%	40.7%	31.9%	27.9%
Të dytën	24.3%	21.3%	21.5%	27.9%
Të tretën	16.2%	15.2%	18.5%	18.6%
Të katërtën	7%	9.9%	11.9%	8.1%
Më poshtë se e katërta	13.5%	11.8%	14.1%	14.0%
Nuk e kam zgjedhur në formularin A3/A4	3.8%	1.1%	2.2%	3.5%

Sa i përket shpërndarjes demografike të shkallës së preferencave sipas ndarjes së LSMS¹⁸ vihet re se maurantët e zonave rurale dhe ata të qyteteve të vogla paraqiten më pak të favorizuar krahasuar me maurantët e tjerë sa i përket pranimit në universitete/degë të cilat përbënin preferencën e parë për ta. Tabela e mësipërme paraqet më qartë këtë shpërndarje. Ajo tregon se qyteti i Tiranës dhe qytetet kryesore të vendit paraqiten më të favorizuara sa i përket shkallës së përputhjes midis preferencës së parë dhe universitetit/degës në të cilin studenti ndjek studimet, ndërsa në shkallëzimin e mëtejshëm të preferencave situata shkon drejt balancës. Kjo panoramë mund të shpjegohet me disa arsye, por më e rëndësishmja midis tyre mund të jetë shpërndarja e pabarabartë e burimeve dhe cilësisë së shërbimit arsimor në territorin e vendit.

18 LSMS - Living Standard Measurement Study – Studimi i Matjes së Standardeve të Jetesës


Mekanizimi meritë - preferencë ndihmon në shpërndarjen eficiente të trupës së maturantëve në universitetet publike, por nga ana tjetër përcakton mjaft edhe shkallën e motivimit të studentit lidhur me degën e studimit dhe përgatitjen në profesionin përkatës. Në një mjedis të tillë shoqëror ku meritokracia, përgjegjshmëria profesionale dhe konkurrenca e shëndetshme nuk përbëjnë mekanizmat kryesorë në ndërtimin e marrëdhënieve mes njëri-tjetrit, sigurisht që motivimi i brendshëm i studentit për të përparuar në aspektin akademik dhe profesional përbën një faktor themelor në përcaktimin e performancës së tij. Studimi tregon se rreth 63% e studentëve shprehen të motivuar në ndjekjen e studimeve në degën ku ata janë regjistruar, e ndjekur kjo nga 26% e studentëve, të cilët ndihen deri diku të motivuar.



Shkalla e motivimit ndikohet, gjithashtu, edhe nga vlerësimi i studentit mbi vlerën dhe dobinë e investimit të tij në suksesin profesional dhe karrierën e mëvonshme. Për të kuptuar më shumë rreth kësaj çështjeje anketa u interesua për shkallën e besimit të studentëve të vitit të dytë të peshës së diplomës në aksesin e tregut të punës. Nga analiza e të dhënave rezulton se ashtu si dhe në rastin e rezultateve mbi motivimin e studentëve, rreth 66% e studentëve besojnë se diploma e shkollës së lartë do t'i ndihmojë për t'u integruar në tregun e punës, e ndjekur kjo nga rreth 27% e studentëve që shprehen të pasigurt dhe rreth 6% e tyre, të cilët mendojnë se diploma nuk do t'i ndihmojë për të siguruar një punë.

Nga rezultatet e anketës duket se masa më e madhe e studentëve që vendosen në kategorinë e të pasigurtve me 32%, si dhe në kategorinë e atyre që shfaqen skeptikë ndaj vlerës së diplomës, me 8%, janë studentë banorë të qytetit të Tiranës. Duket se kjo diferencë midis studentëve banues në qytetin e Tiranës dhe të tjerëve


mund të lidhet me disa faktorë, ndër të cilët mund të rendisim shkallën më të lartë të informimit të studentëve të Tiranës ndaj natyrës së tregut të punës së këtij qyteti, i cili përbën dhe tregun më të madh dhe më konkurrues në territorin e vendit.



Gjithashtu, studentët banorë të përhershëm të Tiranës mund të jenë më të vetëdijshëm për rolin e një diplome universitare në tejkalimin e pengesave të lidhura me informalitetin, nepotizmin apo edhe korrupsionin në rekrutime brenda tregut të punës. Gjithashtu, një shpjegim tjetër mund të jetë edhe niveli më i lartë i pritshmërive midis studentëve banorë të përhershëm të Tiranës kundrejt cilësisë së universitetit. Kjo pasi ata shfaqen më të pakënaqurit për cilësinë e shkollimit sa i përket degës së tyre të studimit.


Pavarësisht shkallës relativisht më të lartë të pakënaqësisë së studentëve banorë të përhershëm të Tiranës për cilësinë e shkollimit në fakultetin ku ata studiojnë, anketa tregon se rreth 50% e studentëve të përfshirë në studim shprehen të kënaqur me cilësinë e shkollimit të tyre, e ndjekur kjo nga rreth 40% e studentëve të cilët shfaqen të pasigurt. Një përqindje dukshëm më e vogël, rreth 11% e studentëve, deklarojnë se nuk janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies në degën e tyre të studimit. Sidoqoftë nga një analizë më e hollësishme vihet re se një përqindje e lartë, rreth 51% e studentëve banorë të zonave rurale, shfaqen të pasigurt për cilësinë e shkollimit në degën e tyre. Kjo pasiguri mund të lidhet me shkallën e lartë të pritshmërive të këtyre studentëve ndaj cilësisë së arsimit të lartë, por mund të shpjegohet edhe me vështirësi të shtuara në përshtatjen me mjedisin urban, si dhe me dinamikën e veprimtarive brenda universitetit.

Figura 10. Sa të kënaqur jeni me cilësinë e shkollimit tuaj të lartë?



Paçka se shumica dërrmuese e studentëve shprehen se lëndët e shkollës së lartë janë dukshëm më të vështira krahasuar me ato në shkollën e mesme, koha që ata shpenzojnë për t'u përgatitur për to paraqitet e njëjtë me kohën që shpenzohej për t'u përgatitur për lëndët e shkollës së mesme. Një përkushtim i ngjashëm në kohë përgjatë këtyre dy periudhave të studimit tregon për një përgjigje aspak propocionale lidhur me shkallën e vështirësisë dhe ngarkesën gjatë studimeve universitare, gjë që sëbashku me faktorë të tjerë mund të shpjegojë rënien e vetëvetishme të performancës akademike nga shkolla e mesme në atë të lartë.


Figura 11. Mesatarisht, sa orë në ditë keni studiuar gjatë vitit të parë të shkollës së lartë?



Me tej studentët u pyetën lidhur me disa prej treguesve kryesorë të cilësisë dhe përshtatjes së tyre me shkollën e lartë. Nga figura e mëposhtme duket se disa prej treguesve të rëndësishëm të procesit të transferimit të dijes dhe vlerësimit të saj nuk marrin vlerësim të lartë nga studentët. Rezultatet e anketës tregojnë se një pjesë e mirë e studentëve deklaroi se nuk i ka përvetësuar në një nivel të kënaqshëm lëndët e vitit të parë. Më tej figura tregon se një pjesë e madhe e studentëve konfirmojnë se përgjithësisht pedagogët nuk inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të studentëve gjatë orës së mësimi. Gjithashtu, ata deklarohen deri diku të pakënaqur lidhur me gatishmërinë e pedagogëve për të nxitur pyetje nga salla dhe për t’iu përgjigjur atyre përmes argumenteve. Pakënaqësia më e madhe e studentëve shkon tek objektiviteti dhe paanashmëria e vlerësimit me nota. Ata shprehen të pakënaqur dhe mosbesues ndaj masës së drejtësisë dhe korrektesës në të cilën janë bazuar pedagogët për të vlerësuar përgatitjen e studentëve. Panorama e mësipërme flet për një proces mësimdhënieje mekanik, i cili nuk mbështetet në pjesëmarrjen aktive të studentëve përgjatë ndërtimit, negocimit dhe transferimit të dijeve dhe kompetencave.

Në një shkallë nga 1 në 10, ku 1 do të thotë nuk jeni aspak dakord dhe 10 do të thotë se jeni shumë dakord, sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme në lidhje me eksperiencën tuaj në VITIN E PARË TË UNIVERSITETIT?	Vlerësimi
UT7.1 I kam kuptuar dhe mësuar lëndët e zhvilluara në vitin e parë të shkollës së lartë	7
UT7.2 Mendoj se lëndët e zhvilluara gjatë vitit të parë të shkollës së lartë kanë qenë sfiduese dhe nxitëse nga pikëpamja	7
UT7.3 Nga lëndët e ndjekura në universitet kam mësuar gjëra që mendoj se janë të vlefshme	8
UT7.4 Shpjegimet e pedagogëve në lidhje me lëndët kanë qenë të qarta dhe të kuptueshme	7
UT7.5 Në përgjithësi pedagogët i bënin lëndët interesante	7
UT7.6 Në përgjithësi pedagogët inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësve gjatë diskutimeve në klasë	6
UT7.7 Pedagogët i inkurajonin studentët të bënin pyetje gjatë orëve të mësimi dhe jepnin përgjigje të vlefshme për këto	6
UT7.8 Tekstet dhe materialet e tjera ndihmëse kanë qenë të përgatitura mirë	7
UT7.9 Vlerësimi i performancës së studentëve (notat) ka qenë i drejtë dhe i përshtatshëm	6
UT7.10 Përmbajtja e provimeve apo vlerësimeve të tjera (projekte etj.) i përshtatej asaj çka ishte shpjeguar më parë në	7

Ashtu siç u përmend edhe më parë, shumica dërrmuese e studentëve shprehet për një nivel të lartë vështirësie të lëndëve të vitit të parë në shkollën e lartë krahasuar me lëndë të njëjta apo të ngjashme në shkollën e mesme.




Ky shqetësim qartësohet edhe më tepër pasi rreth 59% e studentëve shprehen se lëndët e vitit të parë kanë pak apo aspak lidhje/vazhdimësi me lëndët e shkollës së mesme. Këto dy rezultate dëshmojnë për njëfarë tranzicioni të befte dhe disi tronditës nga shkolla e mesme në shkollën e lartë. Kjo duke pasur parasysh se më shumë se 90% e studentëve shprehen se ngarkesa e punës në shkollën e lartë është shumë më e lartë apo më e lartë se ajo gjatë shkollës së mesme.

Sigurisht që kalimi nga shkolla e mesme në shkollën e lartë shoqërohet me shtim të ngarkesës së studimit, nivelit të vështirësisë së dijeve apo një shmangie apo ripërcaktim i trajektores së lëndëve krahasuar me shkollën e mesme, por nga ana tjetër viti i parë në arsimin e lartë duhet të përbëjë një periudhë të tranzicionit gradual si në aspektin e përmbajtjes, procesit të mësimdhënies, studimit, ashtu edhe të praktikave institucionale. Mungesa e trajtimit serioz të këtyre aspekteve mund të ketë ndikim serioz në uljen e performancës akademike të studentëve, si dhe në zbehjen e motivimit për të studiuar, shtuar këtu edhe faktorë të tjerë që lidhen me mungesën e një praktike të meritokracisë në vlerësimin e studentëve, si dhe në karrierën e mëvonshme të tyre në tregun e punës.

SHKOLLA MESME VS. SHKOLLA E LARTE

Në përgjithësi si do ta vlerësonit ngarkesën e punës gjatë shkollës së lartë krahasimisht me ngarkesën që keni pasur gjatë shkollës së mesme?



33.9%
Janë të lidhura

7.2%
Janë shumë të lidhura

**SA LIDHJE KANË LËNDËT E KRYERA
GJATË VITIT TË PARË TË SHKOLLËS
SË LARTË ME LËNDËT E GJIMNAZIT?**

41.5%
Janë deri diku të lidhura

11.9%
Nuk janë të lidhura

5.6%
Nuk janë aspak të lidhura



FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË

Rr. Qemal Stafa, Pallati 120/2, Tirana, Albania

Tel: +355 4 22 34 621 / 22 34 223 / 22 35 856

Fax: +355 4 22 35 855

E-mail: info@soros.al

Web-page: www.soros.al

